



# **RI-THEMELIMI DHE REFORMIMI I SISTEMIT TË DREJTËSISË NË KOSOVË**

**1999 - 2011**

**ANALIZË KONTEKSTI**

**MAJ 2011**

Publikuar nga:

**Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS)**

[www.qkss.org](http://www.qkss.org)

Rr. Qamil Hoxha 2-2, 10 000 Prishtinë, Kosovë

Tel/Fax +381 (0) 38 221 – 420

Email: [info@qkss.org](mailto:info@qkss.org)

Raport mbi:

**RI-THEMELIMIN DHE REFORMIMIN E SISTEMIT TË DREJTËSISË NË KOSOVË 1999 -  
2011**

**ANALIZË KONTEKSTI**

Përkthyer në shqip:

**Sofije Kryeziu**

© E drejta e autorit

*Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet apo të ndryshohet pa lejen e paraprake të botuesit. Opinione të shprehura në publikimin e shkruar apo elektronik janë të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të partnerëve të Qendrës.*

## PARATHËNIE

Ky është publikimi i parë i QKSS-së që elaboron zhvillimin e sistemit të drejtësisë në Kosovë. Publikimi del në përputhje me vizionin strategjik të QKSS për 2011-2013 që përcakton zgjerimin e kapaciteteve hulumtuese edhe në çështjet e drejtësisë në mënyrë që të komplementohen përpjekjet hulumtuese aktuale në çështjet e sigurisë. Ekipi dëshiron të falenderoj mbështetjen e Fondacionit për Shoqëri të Hapur – “Think Tank Fund” për mundësimin e hulumtimit dhe publikimit. Përveç kësaj, vlen të theksohet mbështetja e përgjithshme institucionale e “Think Tank Fund” me qëllim të fuqizimit të kapaciteteve dhe aftësive të hulumtuesve të QKSS-së.

Publikimi “Ri-themelimi dhe reformimi i sistemit të drejtësisë në Kosovë (1999-2011)” është një analizë e kontekstit që në mënyrë holistike analizon zhvillimet kyçe politike e të sigurisë që ndikuan konsolidimin e sistemit të drejtësisë në Kosovë. Publikimi është i ndarë në disa pjesë në mënyrë që të reflektojë faktorët kryesor ndikues gjatë gjithë periudhës dymbëdhjetëvjeçare. Për më shumë, publikimi i kushton vëmendje bazës ligjore që rregullonte sistemin e drejtësisë, përgjegjësive të rezervuara të pranisë(ve) ndërkombëtare në Kosovë dhe sistemit të drejtësisë në veri të vendit. Megjithatë, duke pasur parasysh një sektor kompleks me mekanizma të ndryshëm, nuk ishte qëllimi i hulumtuesve që të thellohen në analizimin e disa aspekteve specifike në sferën e drejtësisë por mbi të gjitha, të ofrojnë një pasqyrë të gjerë. Në fakt, ky publikim pritet të shërbejë si bazë për publikimet e ardhshme të QKSS-së të cilat do të kenë për qëllim t’i adresojnë në mënyrë specifike aspekte të rëndësishme në sferën e sundimit të ligjit.

Publikimi pritet të shërbejë si një burim i rëndësishëm për studentët, hulumtuesit dhe politik-bërësit që dëshirojnë të lexojnë një pasqyrë të përgjithshme për zhvillimet në këtë sektor.

Ekipi i QKSS-së

## PËRMBAJTJA

PARATHËNIE.....	3
LISTA E SHKURTESAVE.....	5
HYRJE.....	7
VENDOSJA E UNMIK-UT DHE "SISTEMIT EMERGJENT TË DREJTËSISË" (QERSHOR – DHJETOR 1999).....	8
Struktura e UNMIK-ut .....	8
"Sistemi Emergjent Gjyqësor" .....	9
FUNDI I STRUKTURAVE PARALELE – STRUKTURAT E PËRBASHKËTA TË PËRKOHSHME ADMINISTRATIVE (Janar 2000 – Maj 2001) .....	10
Ngritja e Strukturës së Përbashkët të Përkohshme Administrative .....	10
Sistemi i Drejtësisë në SPPA.....	11
KORNIZA KUSHTETUESE PËR VETËQEVERISJE TË PËRKOHSHME (Maj 2001 – Shkurt 2008) .....	13
Krijimi i Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes .....	13
Standardet para Statusit .....	16
Pasojat e "trazirave të Marsit të vitit 2004" .....	17
Bisedimet për Statusin .....	20
SISTEMI I DREJTËSISË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS.....	23
Sistemi i Drejtësisë në kuadër të Kushtetutës së Republikës së Kosovës – Pasqyrimi .....	23
Reforma e Sistemit të Drejtësisë .....	26
Nga Misioni i ESDP në EULEX .....	29
Roli i UNMIK-ut në Sistemin e Drejtësisë pas Pavarësisë .....	32
Sistemi i Drejtësisë në Veri të Kosovës .....	32
PËRFUNDIME .....	33
LISTA E LEGJISLACIONIT .....	34

## LISTA E SHKURTESAVE

AKM	Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
BE	Bashkimi Evropian
ESDP	Politikat Evropiane të Mbrojtjes dhe Sigurisë
EULEX	Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
EUSR	Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian
GjSK	Gjykata Supreme e Kosovës
GKEPGJ	Grupi Këshillues për Emërimet e Përkohshme të Gjyqtarëve
ICO	Zyra Civile Ndërkombetare
IGJK	Instituti Gjygjësor i Kosovës
IPVQ	Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës
KDPK	Këshilli i Drejtësisë dhe Prokurorial Kosovës
KGJK	Këshilli Gjygjësor i Kosovës
KKVP	Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme
KPGJPK	Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës
KRK	Kushtetuta e Republikës së Kosovës
KRKB	Komisioneri i Lartë për Refugjatët i Kombeve të Bashkuara
KSKB	Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara
KTK	Këshilli Tranzitor i Kosovës
LDB	Lëvizja Demokratike e Bashkuar
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PPDK	Partia e Progresit Demokratik në Kosovë
PSRL	Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
RSD	Reformimi i Sistemit të Drejtësisë

SAD	Sistemi Ad-Hok i Drejtësisë
SPPA	Struktura të Përbashkëta të Përkohshme Administrative
SPSK	Zyra e Prokurorisë Speciale të Kosovës
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

## HYRJE

Sundimi efektiv i ligjit në Kosovë ishte dhe mbeti një ndër aspektet kyçe për zhvillimin politik, ekonomik, qëndrueshmërinë sociale dhe siguri. Sistemi funksional i drejtësisë është çelësi i sundimit efektiv të ligjit. Mënyra se si sistemi i drejtësisë është i organizuar përbën bazën për të konstatuar se deri në ç'masë sistemi është në gjendje të përmbushë rolin që ka. Pasqyrimi i shkurtër i zhvillimit të sistemit të drejtësisë në Kosovë që nga viti 1999 synon t'i nënvizojë politikat kyçe të miratuara nga UNMIK-u dhe më vonë nga Republika e Kosovës në të cilën strukturimi dhe organizimi i sistemit të drejtësisë reflekton një sfond të problemeve, sfidave dhe dobësive që ndërliidhen me sundimin e ligjit në Kosovë.

Ky pasqyrim historik është i bazuar në mendimin se çdo formë organizative politike, administrative apo gjyqësore, reflekton probleme në periudha të ndryshme dhe si i tillë dokumenti synon t'i adresoj këto në kontekst të organizimit të tyre. Megjithatë, me kalimin e kohës politikat dhe qëllimet reale sikur u futën nën 'hijen' e problemeve dhe sfidave të reja të cilat u shfaqën në kontekst të ndryshëm historik. Në mënyrë që të shtjellojmë më mirë institucionet dhe organet ekzistuese të drejtësisë, është më se e rëndësishme ta kuptojmë kontekstin historik që ka shtyrë formimin dhe strukturimin e sistemit. Reformimi i institucioneve ekzistuese nuk mund të bëhet pa i konsideruar paralelisht 'qëllimet që kishin këto institucioneve në të kaluarën' si dhe 'sfidat e tyre të tanishme'. Për këtë arsye, ky dokument ka për qëllim që të paraqesë çdo fazë të zhvillimit të sistemit të drejtësisë në Kosovë në kontekstin politik, historik e juridik duke shtjelluar rrjedhimisht arsyet dhe qëllimet reale që konkretizuan formimin e sistemit gjyqësor që ekziston në ditët e sotme.

Hulumtimi mbulon periudhën prej vitit 1999 ku Misioni i UNMIK-u zbarkoi në Kosovë me qëllim të themelimit të administratës së përkohshme e deri në kohën kur sistemi i drejtësisë u vendos nën ombrellën e Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Dokumenti është i ndarë në katër periudha të mëdha siç është vendosja nga UNMIK-u e një sistemi emergjent gjyqësor (Qershor deri Dhjetor 1999), sistemi i drejtësisë nën Strukturën e Përbashkët Administrative të Përkohshme (Janar 2000 deri Maj 2001), sistemi i drejtësisë në kuadër të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje në Kosovë (Maj 2001 deri Shkurt 2008) dhe sistemi i drejtësisë në kuadër të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Secila periudhë është e nën-ndarë bazuar në ngjarje të ndryshme politike e juridike që karakterizojnë atë periudhë.

Kjo pasqyrë bazohet mbi të gjitha në vlerësimin e instrumenteve ligjore që kanë adresuar çështjet lidhur me organizimin e sistemit të drejtësisë. Si të tilla janë kryesisht rregulloret dhe udhëzimet administrative të lëshuara nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP); ligjet e Institucioneve të Përkohshme Vetë-Qeverisëse por të shpallura nga PSSP si dhe ligjet e miratuara nga Republika e Kosovës. Një pjesë e madhe e vlerësimit të politikave në sistemin e drejtësisë rrjedh nga raportet e PSSP-së të paraqitura në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të cilat ofrojnë një burim të pasur dhe të rëndësishëm lidhur me rrugëtimin e Kosovës në zhvillimin politik që nga Qershori 1999 deri në ditët e sotme.

Në mënyrë që hulumtimi të fokusohet në aspektet kyçe që karakterizuan zhvillimin e sistemit të drejtësisë dhe politikat përkatëse, përveç strukturës organizative shumë segmente të rëndësishme të sistemit të drejtësisë janë prekur tërthorazi ose fare nuk janë elaboruar siç janë forenzika, bashkëpunimi juridik ndërkombëtar, edukimi ligjor etj. Megjithatë, ky dokument është paraparë të shërbejë përtej qëllimit thjesht informativ të zhvillimit organizativ të sistemit të drejtësisë. Hulumtimi si i tillë pritet të shërbejë si kornizë për vlerësime të mëtutjeshme të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë e cila në

studimet e rradhës do të filloj analizimin e performancës dhe efektivitetit të sistemit të drejtësisë. Pra, lexuesi mund ta konsideroj këtë hulumtim si një dokument të parë dhe kapitull hyrës të një serie hulumtimesh në këtë sferë.

## VENDOSJA E UNMIK-UT DHE "SISTEMIT EMERGJENT TË DREJTËSISË" (QERSHOR – DHJETOR 1999)

### Struktura e UNMIK-ut

Me 10 qershor 1999, Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara miratoi Rezolutën 1244, që autorizon Sekretarin e Përgjithshëm të vendos pranin ndërkombëtare në Kosovë në mënyrë që të krijoj një administratë të përkohshme për Kosovën, duke ndërtuar dhe mbikqyrur zhvillimin e institucioneve të përkohshme demokratike vetëqeverisëse, me qëllim të krijimit të kushteve të nevojshme për të siguruar jetesë paqësore dhe kushte normale për të gjithë banorët e Kosovës.

Në bazë të rezolutës 1244, autoriteti i përkohshëm i administratës civile, i njohur si Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), është themeluar dhe mëveshur me autoritet mbi gjithë territorin e Kosovës. UNMIK-u ishte i përbërë nga katër komponente kryesore të udhëhequra nga Kombet e Bashkuara të cila ishte përgjegjëse për administratën civile, e të cilat ishin të mbështetur nga UNHCR (çështjet humanitare), OSBE (ndërtimi i institucioneve) dhe BE (rindërtimi).

Të gjitha kompetencat legjislative dhe ekzekutive, duke përfshirë edhe administrimin e gjyqësorit, iu mveshën Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), si zyrtari civil më i lartë ndërkombëtar i UNMIK-ut. PSSP-ja kishte autoritetin që të caktojë një person të caktuar për të kryer funksionet në administratën e përkohshme civile, duke përfshirë gjyqësorin dhe për të hequr persona të tillë në qoftë se shërbimi i tyre nuk ishte në pajtim me mandatin dhe qëllimet e administratës së përkohshme civile. Për më shumë, PSSP kishte autorizime për të ndryshuar, anuluar ose pezulluar ligjet ekzistuese në masën e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të tij, ose aty ku ligjet ekzistuese ishin të papajtueshme me mandatin, synimet dhe qëllimet e administratës së përkohshme civile. PSSP-ja ishte autorizuar edhe për të nxjerrë akte ligjore në formë të rregulloreve, të cilat do të mbeten në fuqi derisa të shfuqizohen nga PSSP-ja.

PSSP-ja gjatë gjithë punës së tij mbështej nga një Zëvendës kryesor dhe secila komponentë drejtohej nga një Zëvendës i PSSP i emëruar nga ana e organizatave ndërkombëtare përgjegjëse për mbështetjen e komponentës përkatës. Përderisa zëvendësit e PSSP-së mbanin përgjegjësi për aktivitetet që ishin në kuadër të komponentës përkatëse, vet PSSP-ja mbante autoritetin përfundimtar mbi të gjitha komponentët e UNMIK-ut dhe është i autorizuar për të drejtuar aktivitetet e secilit komponent për të siguruar një zbatim koherent të objektivave të misionit të UNMIK-ut.

PSSP mbështetej nga Komision Ekzekutiv dhe një Zyrë Ekzekutive, duke përfshirë personelin për të këshilluar mbi çështjet politike, ligjore dhe ekonomike.



Menjëherë pas vendosjes së UNMIK-ut, PSSP themeloi Këshillin Tranzitor të Kosovës (KTK), i cili mbledhi së bashku të gjitha partitë e mëdha politike dhe grupet etnike në Kosovë. Themelimi i KTK u konsiderua si një hap fillestar drejt krijimit të një kornize gjithëpërfshirëse të strukturave më të gjëra dhe më demokratike që mbulonte të gjitha aspektet jetësore në Kosovë.

## "Sistemi Emergjent Gjyqësor"

Pas vendosjes, UNMIK-u ishte gjetur në një situatë ku Kosova ndodhej në gjendje kaosi, shkatërrimi ekonomik, rrënimi të gjerë, mungese të ligjeve, shprehje të hapura të ndjenjave hakmarrëse dhe në fillim me shumë pjesë thuajse të boshatisur nga popullsia e saj. Sipas UNMIK-ut, problemet e sigurisë në Kosovë ishin kryesisht rezultat i mungesës së institucioneve dhe agjencive të ligjit dhe rendit. Gjyqësori nuk funksiononte pasi që shumë prej stafit të mëparshëm ishin larguar, dhe shqiptarët e Kosovës apo personeli tjetër ose nuk ishte kthyer ende në Kosovë ose ende nuk ishin rekrutuar. Si një çështje me prioritet, PSSP menjëherë pas vendosjes së tij ndërmori hapat fillestar për rindërtim të një sistem gjyqësor multi-etnik dhe të mbështetur mbi parimet demokratike.

Si hap të parë, PSSP lëshoi tri dekrete emergjente, një për themelimin e Këshillit të Përbashkët Konsultativ mbi Emërimet e Përkohshme Gjyqësore, një për anëtarët e saj dhe e treta për emërimin e katër prokurorëve, dy gjyqtarë hetues dhe një panel prej tre gjyqtarësh . "Sistemi emergjent gjyqësor" u inicua më 30 Qershor 1999 me hapjen e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, e ndjekur nga hapja e gjykatave në Prizren, Pejë, Gjilan dhe Mitrovicë dhe e mbështetur nga gjykatat mobile. Pas emërimeve fillestare, PSSP-ja, pas konsultimeve me Këshillin Konsultativ të Përbashkët mbi Emërimet e Përkohshme Gjyqësore, emëroi 36 gjyqtarë dhe 12 prokurorë në baza të përkohshme për të shërbyer në këtë sistem emergjent gjyqësor.

Brenda strukturës së UNMIK-ut, PSSP-ja kishte themeluar Zyrën për Çështje Ligjore, e cila fillimisht ishte përgjegjëse për (i) administrimin e gjykatave, prokurorisë dhe burgjeve, (ii) zhvillimin e politikave ligjore, (iii) rishikimin dhe hartimin e legjislacionit, dhe (iv) vlerësimin e cilësisë së drejtësisë në Kosovë. Megjithatë, menjëherë pas kësaj, zhvillimi i politikave ligjore dhe rishikimi dhe hartimi i legjislacionit u transferuan te Këshilltari Ligjor i PSSP-së. Zyra për Çështje Ligjore mbeti përgjegjëse vetëm për aspektet operative të sistemit gjyqësor.

Më tej, PSSP-ja e themeloi një gjykatë të instancës më të lartë, e cila do të kishte kompetencat e Gjykatës Supreme të Kosovës sa i përket ankesave kundër vendimeve të Gjykatave të Qarkut dhe deri në atë kohë kur të ri-themelohej Gjykata Supreme. Prokuroria ishte ri-themeluar me emërimin e një Kryeprokurori Publik dhe një Zëvendës Prokurori Publik. Emërimet fillestare në Gjykatën e Apelit Final dhe Zyra e Prokurorit Publik janë bërë nga PSSP-ja pas konsultimeve me Këshillin Konsultativ të Përbashkët mbi Emërimet e Përkohshme Gjyqësore.

Në Shtator të vitit 1999, PSSP-ja themeloi Komisioni Këshillues Gjyqësor, i cili zëvendësoi Këshillin Konsultativ të Përbashkët mbi Emërimet e Përkohshme Gjyqësore. Komisioni Këshillues Gjyqësor ishte i përbërë nga tetë ekspertë lokal dhe tre ndërkombëtarë, të përzgjedhur dhe emëruar nga PSSP-ja. Ky Komisioni ishte përgjegjës për të ftuar që të aplikojnë profesionistët ligjor për të shërbyer si gjyqtarë ose prokurorë, për shqyrtimin e kërkesave individuale dhe për të rekomanduar PSSP-në për emërimin e kandidatëve si gjyqtarë ose prokurorë. Komisioni Këshillues Gjyqësor ishte gjithashtu përgjegjës për këshillimin e PSSP-së mbi çështjet që lidhen me ankesat ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve. PSSP-ja mbajti

autoritetin përgjegjës për emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në nëntor të vitit 1999, PSSP-ja zgjeroi përgjegjësitë e Komisionit Këshillues Gjyqësor që të këshillojë PSSP-në lidhur me çështjet e emërimit të gjyqtarëve porotë dhe ankesat kundrejt tyre.

Së bashku me krijimin e Komisionit Këshillues Gjyqësor, PSSP-ja themeloi Komisionin Këshillues Teknik në Shërbimin Gjyqësor dhe atë të Prokurorisë, i cili përbëhej nga dhjetë anëtarë lokale dhe pesë ndërkombëtarë, të përzgjedhur dhe emëruar nga PSSP-ja. Funksioni i Komisionit Këshillues Teknik në Shërbimin Gjyqësor dhe të Prokurorisë ishte për të vlerësuar kërkesat aktuale dhe afatgjata të Kosovës për shërbimin e prokurorisë dhe çështjeve që i përkasin numrit, niveleve dhe kategorive të organeve gjyqësore, si dhe të këshillojë PSSP-në për ri-themelimin e Gjykatës Supreme të Kosovës. Në fillim të vitit 2000, Komisioni Këshillues Teknik në Shërbimin Gjyqësor dhe atë të Prokurorisë propozoi krijimin e një gjykate për ndjekjen e krimeve etnike. Mirëpo, kjo ide nuk ishte marrë seriozisht nga UNMIK-u e cila në ndërkohë u anashkalua totalisht si e panevojshme..

Në fund të vitit 1999, sistemi emergjent i drejtësisë kishte 301 gjyqtarë dhe prokurorë dhe 238 gjyqtarë porotë. Sipas UNMIK-ut, ndaj gjykatësve, prokurorëve dhe avokatëve, e në veçanti ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të sistemit emergjent gjyqësor, kishin filluar të ushtrohej presion të konsiderueshëm dhe të kërcënoheshin gjatë kryerjes së detyrave të tyre. Nga fund i vitit 1999 UNMIK-u e kishte pranuar edhe zyrtarisht se ruajtja e frymës multietnike të gjyqësorit po bëhej gjithnjë e më e vështirë. UNMIK po ashtu njoftoi se një ndjenjë në rritje e frikës po rrezikonte përpjekjet për të krijuar shtetin e së drejtës. Dëshmitarët e shkeljeve të të drejtave të njeriut shpesh nuk pranuan të japin informacion në polici, e edhe në qoftë se një gjë të tillë e kishin bërë, më pas e tërhiqnin dëshminë e tyre ose nuk paraqiteshin fare nëpër seancat gjyqësore. Gjyqtarët dhe prokurorët vëheshin nën kërcënime duke ju kërkuar që ata të mos nisin hetimet kundër të dyshuarve të caktuar ose të bëjnë lirim të tyre, pavarësisht nga provat bindëse inkriminuese të mbledhura nga KFOR-i apo UNMIK-u. Kështu pa-ndëshkueshmëria i krijoi UNMIK-ut probleme që dëmtuan përpjekjet thelbësore për ndërtimin e një sistemi të pavarur të drejtësisë. Për më shumë, rritja e masave të sigurisë për mbrojtjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve provoi të jetë një tjetër sfidë.

## FUNDI I STRUKTURAVE PARALELE – STRUKTURAT E PËRBASHKËTA TË PËRKOHSHME ADMINISTRATIVE (Janar 2000 – Maj 2001)

### **Ngritja e Strukturës së Përbashkët të Përkohshme Administrative**

Më 15 dhjetor 1999, drejtuesit e grupacioneve politike të Partisë së Progresit Demokratik të Kosovës (PPDK), Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Partisë Lëvizja e Bashkuar Demokratike (LBD) ranë dakord të marrin pjesë në themelimin nga ana e UNMIK-ut të një Struktura të Përbashkët të Përkohshme Administrative (SPPA) Kosovë-UNMIK. SPPA do të respektonte dhe veprojë në bazë të Rezolutës 1244 dhe do njej autoritetin legjislativ dhe ekzekutiv të PSSP-së. Sipas Marrëveshjes së SPPA-së, të gjitha strukturat paralele të një natyre ekzekutive, legjislative apo gjyqësore kërkoheshin të shpërbëheshin deri më 31 Janar 2000. UNMIK-u raportoi se për herë të parë, pas dhjetë viteve të një

sistemi të "dyfishtë" të qeverisjes dhe administratës, një angazhim formal për të shpërbërë strukturat paralele u pranua nga udhëheqja e shqiptarëve të Kosovës. Të gjitha strukturat paralele të shqiptarëve të Kosovës deklaruan se pushojnë së ekzistuari në 31 janar 2000, duke përfshirë edhe "Qeverinë e Përkohshme të Kosovës" dhe "Presidencën e Republikës së Kosovës".

SPPA përbëhej nga Këshilli Tranzitor i Kosovës, Këshilli i Përkohshëm Administrativ dhe 20 Departamente Administrative. Këshilli Tranzitor i Kosovës ka vazhduar rolin e tij si një organ konsultativ, ndërsa Këshilli i Përkohshëm Administrativ ishte përgjegjës për të i bërë rekomandime PSSP-së për ndryshimet e ligjeve në fuqi si dhe nxjerrjen e rregulloreve dhe udhëzimeve të reja politike për Departamentet Administrative.

Secili Departament Administrativ kryesohej nga dy Bashkë-Kryetar. Përfaqësuesi i UNMIK-ut dhe ai lokal ishin emëruar nga PSSP-ja, pas konsultimeve me Kryesuesit lokal në kuadër të Këshillit të Përkohshëm Administrativ. Përderisa dy Bashkë-Kryetarët ndanin përgjegjësitë të secilit Departament Administrativ, përfaqësuesi i UNMIK-ut mbajti një përgjegjësi të veçantë dhe ekzekutive për të u siguruar se dispozitat dhe politikat e parapara me Rezolutës 1244 janë zbatuar nga SPPA. Çdo Departament Administrativ ishte nën mbikëqyrjen e një zëvendësi të PSSP. Çdo rekomandim i politikave bëhej nga ana e departamenteve administrative të Këshillit të Përkohshëm Administrativ nëpërmjet zëvendësit përkatës të PSSP.

## **Sistemi i Drejtësisë në SPPA**

Në mars 2000, PSSP themeloi Departamentin Administrativ të Drejtësisë, përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm të çështjeve që kanë të bëjnë me sistemin gjyqësor dhe shërbimin korrektues dhe për zbatimin e udhëzimeve të politikave të formuluar nga Këshilli i Përkohshëm Administrativ në çështjet që lidhen me sistemin gjyqësor dhe shërbimin korrektues. Më konkretisht, Departamenti Administrativ i Drejtësisë, që vepron nën mbikëqyrjen e Zëvendësit të PSSP për Administratën Civile, ka qenë përgjegjës për:

- Zbatimin e strategjisë së përgjithshme dhe politikat për zhvillimin, organizimin dhe funksionimin e duhur të sistemit gjyqësor dhe shërbimit korrektues në kuadër të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës;
- Propozimin e rregulloreve për zhvillimin, organizimin dhe funksionimin e duhur të sistemit gjyqësor dhe shërbimit korrektues;
- Koordinimin me Departamentet tjera Administrative mbi çështjet që kanë të bëjnë me sistemin gjyqësor dhe shërbimin korrektues;
- Të bashkëpunojë me organizatat përkatëse sa i përket monitorimit të pavarur të sistemit gjyqësor dhe shërbimit korrektues;
- Sigurimi i informacionit dhe statistikave për sistemin gjyqësor dhe shërbimin korrektues, sipas rastit;
- Mbrojtja e të dhënave konfidenciale personale lidhur me sistemin gjyqësor dhe shërbimin korrektues;
- Të lehtësojë ofrimin e burimeve financiare, teknike, të personelit dhe ato materiale për funksionimin e duhur të sistemit gjyqësor dhe shërbimit korrektues;

- Lehtësimi i bashkëpunimit në çështjet gjyqësore dhe korrektuese me subjekte të përshtatshme brenda dhe jashtë Kosovës;
- Asiston në trajnimin e gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve, avokatëve publikë, interpretuesve gjyqësor, përkthyesve, ofiqarëve, personelit ndihmës gjyqësor dhe personelit tjetër relevant;
- Të ndihmojë në përzgjedhjen, emërimin, caktimin dhe shkarkimin nga detyra të nëpunësve dhe personelit ndihmës gjyqësor;
- Ndihton në punësimin, përgatitjen dhe vlerësimin e personelit të shërbimit korrektues;
- Sigurimi për inspektime dhe kontrole të brendshme të burgut të menaxhimit të shërbimit korrektues.

Autoriteti përfundimtar për emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, në bazë të rekomandimeve nga Komisioni Këshillues Gjyqësor, si dhe vendimet përfundimtare mbi politikën dhe legjislacionin mbetën me PSSP-në. Departamenti Administrativ i Drejtësisë ishte i mveshur me përgjegjësinë kryesisht operacionale për sistemin gjyqësor.

Në pikëpamje të trazirave në Mitrovicë dhe rrënimit të strukturave të sigurisë dhe drejtësisë aty, PSSP-ja emëroi për herë të parë në Shkurt të vitit 2000 një gjykatës ndërkombëtarë dhe një prokuror ndërkombëtar në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë. Në Maj 2000, PSSP-ja zgjeroi rregulloren duke u autorizuar për emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë në të gjitha gjykatat në Kosovë. Deri në fund të vitit 2000, dhjetë gjyqtarë ndërkombëtarë dhe tre prokurorë ndërkombëtarë shërbenin nëpër gjykata në tërë Kosovën, përfshirë edhe një gjyqtar ndërkombëtar në Gjykatën e ri-themeluar Supreme të Kosovës. Emërimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtar përtej Mitrovicës është justifikuar nga UNMIK-u si një masë për ndërtimin e besimit në sistemin e drejtësisë. Natyra e veçantë e luftës dhe krimit etnike si dhe numri i rasteve të tilla në Kosovë, ndikoi që panelet të përbëheshin nga dy komponente të ndryshme, nga ajo lokale dhe ajo ndërkombëtare.

Një nga prioritetet kryesore të UNMIK-ut gjatë vitit 2000 ishte rritja e kapacitetit të sistemit të ri-ndërtuar të drejtësisë në Kosovës duke shërndarë burime njerëzore dhe ato materiale në kuadër të tij. Në Gusht të vitit 2000, u emëruan 136 gjyqtarë dhe prokurorë dhe 309 gjyqtarë porotë shtesë nga PSSP, ndërsa 56 gjykatat dhe 13 zyrat e prokurorëve u funksionalizuan. UNMIK vuri re aktivitetet në rritje për shkak të alokimit të burimeve të tilla dhe priti që ky trend të vazhdojë. Gjatë vitit 2000, UNMIK mori masa të tjera mbështetëse për të rritur kapacitetet e pushtetit gjyqësor, duke përfshirë themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës, themelimin e Institucionit të Ombudspersonit, krijimin e Qendrës Juridike të Kosovës dhe ofrimin e mbështetjes për Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës.

Në funksion të rritjes së dhunës ndër-etnike dhe të motivuar politikisht që vërehej nga fundi i vitit 2000, PSSP-ja fillimisht në vitin 2001 përshtati një politikë objektivat e të cilës ishin: (i) ruajtja efektive e kontrollit dhe mbikëqyrjes ndërkombëtare, (ii) zgjerimi i kapaciteteve të misionit për t'iu kundërvënë krimeve të rënda që kërcënonin përpjekjet për ndërtimin e paqës, dhe (iii) zhvillimi i koordinuar për themelimin e të gjitha institucioneve penale të drejtësisë. Mbështetja ndërkombëtare e tillë gjyqësore do të kishte po ashtu rolin udhëheqës në shqyrtimin e numrit të madh të krimeve të luftës, atyre ndër-etnike dhe krimeve të organizuara. Në bazë të kësaj politike, performanca e gjyqtarëve dhe prokurorëve aktual do i nënshtrohet vlerësimeve rigoroze.

Në Prill 2001, PSSP-ja themeloi Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës (KGJPK), i cili zëvendësoi Komisioni Këshillues Gjyqësor që kishte pushuar së funksionuari në Dhjetor të vitit 2000. KGJPK-ja ishte përgjegjës për këshillimin e PSSP-së lidhur me çështjet e emërimit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe gjyqtarëve porotë, si dhe dëgjimin e ankesave dhe marrjen e veprimeve të caktuara disiplinore kundër çdo gjykatësi, prokurori dhe gjyqtari porot. KGJPK përbëhej nga nëntë anëtarë lokal dhe ndërkombëtarë, të përzgjedhur dhe emëruar nga PSSP-ja. KGJPK-ja dhe anëtarët e saj do të jenë të pavarur dhe të paanshëm gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.

KGJPK-ja kishte për detyrë të bënte thirrje për aplikime nga ana e profesionistëve të drejtësisë për të shërbyer në postet e gjyqtarëve, prokurorëve dhe gjyqtarëve porotë; shqyrtonte aplikacionet e tyre dhe ipte rekomandime për emërimin e tyre tek PSSP. Autoriteti përfundimtar për emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe gjyqtarëve porotë i mbeti PSSP-së.

Ankesat kundër një gjyqtari, një prokurori ose gjyqtari porot mund të dorëzohen në KGJPK-ja vetëm nga PSSP-ja ose nga bashkëkryesuesit e Departamentit Administrativ të Drejtësisë. Procedurat disiplinore do të iniciohen nga KGJPK-ja pas dorëzimit të një ankesë të tillë ose me vendimin e vetë KGJPK-së për të nisur procedura të tilla. Hetimet do të drejtohet nga një anëtar i KGJPK apo nga Njësia e Inspektimit Gjyqësor, nëse kërkohet nga KGJPK-ja. Pas hetimeve, KGJPK-ja mund të marrë vendime në lidhje me çortim, vërejtje apo pezullimin e përkohshëm, ndërkohë që vendimet për largimin nga detyra ose funksioni janë të rezervuara për PSSP-në. Seancat e para disiplinore janë zhvilluar në fund të vitit 2001 duke rezultuar në çortim zyrtar të gjyqtarëve dhe zhvendosjen e tyre nga një detyrë në tjetrën.

Njësia e Inspektimit Gjyqësor, e përmendur më lart, ishte themeluar në Maj të vitit 2001 si pjesë e Departamentit Administrativ të Drejtësisë. Përveç kryerjes së hetimeve disiplinore, nëse i kërkohet nga KGJPK-ja, Inspekcioni Gjyqësor ishte gjithashtu përgjegjës për (i) analizimin dhe vlerësimin e funksionimit të gjykatave dhe zyrave të prokurorive publike, (ii) analizimin dhe vlerësimin e veprimtarive të veçanta gjyqësore apo prokuroriale dhe (iii) dhënien e rekomandimeve bashkë-drejtimesve të Departamentit Administrativ të Drejtësisë.

## **KORNIZA KUSHTETUESE PËR VETËQEVERISJE TË PËRKOHSHME (Maj 2001 – Shkurt 2008)**

### **Krijimi i Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes**

Në Maj 2001, PSSP-ja nxorri Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Korniza Kushtetuese), e cila parashkte krijimin e institucioneve të përkohshme Vetëqeverisëse (IPVQ) që përbëheshin nga Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Kosovës, Qeveria, Gjykatat dhe organet tjera dhe institucionet e përcaktuara në kuadër të saj. Departamentet administrative, të cilat ishin themeluar në bazë të SPPA-së, pas miratimit të kësaj Kornize u shëndrruan në Ministri si pjesë e Qeverisë së Kosovës e cila tani më kryesohej nga Kryeministri i saj. Pa ndonjë paragjykim në lidhje me autoritetin përfundimtar legjislativ dhe ekzekutiv të PSSP-së nën rezolutën 1244, IPVQ i janë transferuar përgjegjësi të caktuara,

përfshirë ato që kanë të bëjnë me përgatitjen dhe nxjerrjen e legjislacionit, edhe pse autoriteti përfundimtar për nxjerrjen e ligjeve dhe rregulloreve edhe më tutje i mbetet PSSP-së.

Në lëmin e çështjeve gjyqësore, këto në vijim janë përgjegjësitë e bartura tek IPVQ-të:

- Marrja e vendimeve në lidhje me emërimin e gjykatësve dhe prokurorëve;
- Ushtrimi i përgjegjësiave në lidhje me organizimin dhe funksionimin e duhur të gjykatave, brenda strukturave ekzistuese të gjykatave;
- Zhvillimi, ofrimi dhe mirëmbajtja e gjykatave dhe prokurorisë;
- Sigurimi i kushteve teknike dhe financiare, të personelit ndihmës dhe burimet materiale për funksionim efektiv të sistemit të gjykatave dhe prokurorisë;
- Trajnimi i personelit gjyqësor, në bashkëpunim me OSBE-në;
- Organizimi i provimeve për kualifikimin e gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve dhe profesionistëve të tjerë ligjorë nëpërmjet një organi të pavarur profesional;
- Emërimi, trajnimi, disiplinimi dhe largimi i anëtarëve të personelit ndihmës gjyqësor;
- Sigurimi i koordinimit për çështjet që kanë të bëjnë me sistemin gjyqësor dhe shërbimin korrektues;
- Bashkëpunimi me organizatat përkatëse sa i përket monitorimit të pavarur të sistemit gjyqësor dhe shërbimit korrektues;
- Ofrimi i informacionit dhe statistikave për sistemin gjyqësor dhe shërbimin korrektues;
- Mbrojtja e të dhënave personale lidhur me sistemin gjyqësor dhe shërbimin korrektues;
- Sigurimi i bashkëpunimit në çështjet gjyqësore dhe korrektuese me organet brenda Kosovës;
- Ndihma në punësim, përgatitje dhe vlerësim të personelit për shërbimin korrektues.

Në anën tjetër, kompetencat që vazhduan edhe më tutje të rezervuara për PSSP-në janë:

- Ushtrimi i autoritetit përfundimtar lidhur me emërimin, shkarkimin dhe disiplinimin e gjykatësve dhe prokurorëve;
- Caktimi i gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë;
- Ushtrimi i kompetencave dhe përgjegjësiave të natyrës ndërkombëtare në fushën ligjore;
- Ushtrimi i pushtetit mbi institucionet e zbatimit të ligjit dhe të shërbimit korrektues.

Sipas UNMIK-ut, me qëllim që zbatimi i ligjit dhe drejtësisë të ketë mbikëqyrje ndërkombëtare të qëndrueshme, një gjë e tillë është reflektuar edhe me Kornizën Kushtetuese, e cila edhe më tutje mbajti fushën e drejtësisë dhe policisë në kuadër të kompetencave të veçanta të PSSP-së. Përgjegjësitë të cilat ju transferuan IPVQ-ve në fushën e drejtësisë u vuan nën kompetencat e Ministrisë së Shërbimeve Publike. Korniza Kushtetuese përcaktoi që sistemi gjyqësor të jetë i përbërë nga Gjykata Supreme,

Gjykatat e Qarkut, Gjykatat Komunale dhe Gjykatat për Kundërvajtje. Por ky dokument parashihte edhe Zyrën e Prokurorit Publik, si dhe zyrat e prokurorëve të qarkut dhe komunale. Gjyqtarët dhe prokurorët emëroheshin nga PSSP-ja me propozim të Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës (KGJPK) dhe të miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Gjithashtu, vendimet për transferimin, ngritjen në pozita dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve do të merren nga PSSP-ja bazuar në rekomandimet e KGJPK-së apo me vetiniciativë të këtij të fundit.

Një risi interesante e prezantuar nga Korniza Kushtetuese ishte Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme mbi çështjet e Kornizës Kushtetuese. Dhoma e Veçantë i ngjante një Gjykatë Kushtetuese pasi që ajo kishte juridiksion për të vendosur, në rrethana të veçanta në çështjet në vijim:

- nëse një ligj i miratuar nga Kuvendi ishte në përputhje me Kornizën Kushtetuese apo jo,
- mosmarrëveshjet në mes të IPVQ-ve mbi shtrirjen e të drejtave dhe detyrimeve të tyre në bazë të Kornizës Kushtetuese;
- nëse një vendim i IPVQ shkelë pavarësinë dhe përgjegjësitë e organeve të pavarura;
- në lidhje me imunitetin e një anëtarit të Kuvendit, Qeverisë apo Presidentit të Kosovës.

Megjithatë, kjo Dhomë e Veçantë nuk ka pasur staf dhe nuk ishte funksionalizuar fare, duke mbetur kështu vetëm një "gjykatë në letër".

Një tjetër Dhomë e Veçantë, e quajtur *Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit* ishte themeluar në Qershor të vitit 2002 për të zgjidhur kërkesat në lidhje me vendimet ose veprimet e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit dhe procesit të privatizimit. Gjyqtarët e kësaj Dhomë të Veçantë emëroheshin nga PSSP-ja në konsultim me Kryetarin e Gjykatës Supreme.

Për qëllime të administrimit të kompetencave të rezervuara në fushën e drejtësisë, PSSP-ja kishte themeluar "Shtyllën Policore dhe Gjyqësore", të njohur si "Shtylla I", e kryesuar nga një ushtrues i pozitës së re të krijuar të zëvendësit të PSSP-së. Objektivat e "Shtyllës I" ishin si më poshtë:

- Për konsolidimin e një ligji dhe strukture të rendit që do të ishte përgjegjëse për objektivat e ruajtjes dhe ndërtimit të paqes që do të kontribuojë në promovimin e institucioneve të sundimit të ligjit në Kosovë;
- Për të ruajtur kontrollin efektiv ndërkombëtar dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve policore dhe gjyqësore në kuadër të objektivave afatmesme, në mënyrë që të mund të zbatohet një tranzicion efektiv i menaxhimit në të ardhmen nga ana e komuniteteve të Kosovës;
- Për të përforcuar ndikimin afat-shkurtër në përpjekjet e ligjit dhe rendit përmes koordinimit të zgjeruar të informacionit dhe të punës;
- Për të mundësuar reagim efektiv policor dhe gjyqësor kundër ndonjë aktiviteti të rëndë destabilizues penal në Kosovë;
- Të krijojë një proces të paanshëm gjyqësor përmes pjesëmarrjes fillestare ndërkombëtare dhe reformimit të sistemit gjyqësor.

Krijimi i Shtyllës I u mbështet nga aktivitetet legislative në rritje nga ana e UNMIK-ut për të luftuar krimet e rënda, përfshirë terrorizmin dhe krimin e organizuar me gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtarë duke u fokusuar në krimet e luftës, krimet e motivuara etnikisht, krimin e organizuar dhe krimeve të tjera që mund të kërcënonin procesin e paqes. Është interesant të theksohet se më pak se dy vjet pas vendosjes së UNMIK-ut dhe krijimit të një sistemi emergjent gjyqësor, ky mision tashmë raportonte në lidhje me një reformë të gjyqësorit vendor që do të koordinohet nga Departamenti i tij për Drejtësi, i cili duket se ka trashëguar përgjegjësitë e "rezervuara" të ish-Departamentit Administrativ të Drejtësisë, duke përfshirë përgjegjësinë mbi Njësinë e Inspektimit Gjyqësor.

Departamenti i Drejtësisë poashtu përfshinte edhe një Seksion për Integrim Gjyqësor për të koordinuar strategjinë e rekrutimit të pakicave në gjyqësor, Njësinë për Politikë Ligjore si pikë qendrore për hartimin e politikave dhe bashkëpunimin me agjencitë e Kosovës, dhe një Njësi për Mbrojtjen dhe Asistencën ndaj Viktimave për të ofruar ndihmë për dëshmitarët dhe viktimat gjatë gjithë procesit gjyqësor.

## **Standardet para Statusit**

Në Prill të vitit 2002, PSSP-ja bëri publike fillimin e qasjes "Standardet para Statusit", e që një qasje e tillë u pranua nga ana e IPVQ-ve. Kjo qasje rrjedhi si përgjigje e detyrimeve të UNMIK-ut të dalura nga Rezoluta 1244 për të filluar procesin për përcaktimin e statusit të ardhshëm të Kosovës. Ideja ishte që asnjë çështje e statusit nuk do të adresohet deri sa shoqëria dhe institucionet e Kosovës të tregojnë pjekurin dhe të dëshmojnë se janë të gatshëm të avancojnë në përmbushjen e parakushteve të domosdoshme minimale të kërkuara, kushte këto të cilat janë edhe kërkesa bazë për përmbushjen e standardeve edhe për integritet evropiane. UNMIK-u përcaktoi standarde dhe një sërë treguesish për matje të progresit, ndërkohë që IPVQ-të inkorporuan standardet në programin e tyre të qeverisë dhe krijuan mekanizma për arritjen e progresit të kërkuar, duke përfshirë edhe planet specifike të veprimit. Një nga standardet ishte "sundimi i ligjit" duke "i ndërtuar kapacitetet vendor për zbatim të ligjit dhe ngritje të kapaciteteve në kuadër të sistemit të drejtësisë", si një nga nën-komponent të tij. Kjo politikë ishte e plotësuar në Nëntor 2003 kur PSSP shpalli një mekanizëm për rishikim të progresit të IPVQ-ve drejt përmbushjes së standardeve në kuadër të politikës "standardet para statusit". Në dhjetor 2003, PSSP-ja poashtu lansoi dokumentin "Standardet për Kosovën", i cili dokument vuri në letër dhe përcaktoi në mënyrë të detajuar standardet që Kosova detyrohej të i përmbushte.

Gjatë këtij procesi, një nga prioritetet kryesore të UNMIK-ut ishte që të rrisë numrin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Nga fundi i vitit 2001, sistemi gjyqësor kishte një staf prej 325 gjyqtarëve vendor, 51 prokurorëve, 617 gjyqtarëve porotë, 8 gjyqtarë ndërkombëtarë, 6 prokurorë ndërkombëtarë dhe rreth 1000 zyrtarë mbështetës operativ. Poashtu vlenë të përmendet, që deri në fund të vitit 2001 filluan edhe provimet e jurisprudence. Deri në fund të vitit 2002, ishin 373 gjyqtarë dhe prokurorë, 12 prokurorë ndërkombëtarë dhe 12 gjyqtarë ndërkombëtarë që shërbejnë në sistemin gjyqësor të Kosovës. Në fund të vitit 2003, ishin 316 gjyqtarë, 53 prokurorë, 14 gjyqtarë ndërkombëtarë, 12 prokurorë ndërkombëtarë dhe më shumë se 1300 personel ndihmës të angazhuar në sistemin e drejtësisë. Sipas UNMIK-ut, gjyqtarët dhe prokurorët lokalë trajtonin 100% të rasteve civile dhe rreth 97% të rasteve penale, pjesa e mbetur trajtohej nga gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtarë.

Gjatë viteve 2002-2003, UNMIK bëri përpjekje për të rritur përfaqësimin e komuniteteve pakicë në gjyqësor. Për këtë qëllim, në parim ishte arritur një marrëveshje në korrik të vitit 2002 në mes të PSSP



dhe Ministrin Serb të Drejtësisë, duke siguruar që autoritetet e Republikës Federale të Jugosllavisë do të inkurajonin kandidatët Serbë që të paraqesin aplikimet e tyre për shërbim në sistemin gjyqësor të Kosovës dhe se Qeveria e Serbisë do të garantonte të drejtat e pensioneve dhe sigurimeve shoqërore. Në anën tjetër, UNMIK pranoi për herë të parë se Serbia do të jetë përgjegjëse për shpërbërjen e strukturës së gjykatave paralele në të cilat shumë ish-gjyqtarë dhe prokurorë serbë të Kosovës ishin të punësuar. Rezultate të kësaj marrëveshje ishin ri-hapja e gjykatave në Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe emërimi i 13 pjesëtarëve të komunitetit Serb të Kosovës si gjyqtarë dhe prokurorë në kuadër të sistemit gjyqësor të Kosovës. Megjithatë, deri në fund të vitit 2003, qeveria serbe ende nuk kishte zbatuar angazhimet e saj në lidhje me pagesat e pensioneve dhe përfitimeve tjera për gjyqtarët dhe prokurorët serbë, dhe strukturat paralele gjyqësore ende ekzistonin në Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan, Shtërpce pavarësisht hapjes së gjykatave të UNMIK-ut në ato zona. Për më tepër, UNMIK-u ishte i njoftuar edhe zyrtarisht se "gjykatat paralele të qarkut dhe komunale të Prishtinës" operonin në Nish (Serbi). Megjithë këtë, UNMIK-u intensifikoi edhe më tutje përpjekjet për rritjen e pjesëmarrjes së pakicave, e sidomos pjesëmarrjen e pjesëtarëve të komunitetit serbëve në sistemin gjyqësor të Kosovës, megjithë se të frustruar për shkak të mungesës së bashkëpunimit nga ana e qeverisë serbe dhe shqetësimeve për sigurinë. UNMIK-u gjithashtu bëri përpjekje për rritjen e qasjes së serbëve të Kosovës në gjyqësor me hapjen e një departamenti të gjykatës komunale dhe një gjykatë për kundërvajtje në Shtërpce, dhe me hapjen e zyrave ndërlidhëse të gjykatës në Graçanicë, Novo Bërdë dhe Gorazhdec.

Periodha 2002-2003 poashtu ishte karakterizuar nga shumë "raportime pozitive" në Këshillin e Sigurimit së OKB-së në lidhje me sistemin gjyqësor të Kosovës. Në raportet e saj në Këshillin e Sigurimit gjatë gjithë kësaj periudhe, Sekretari i Përgjithshëm e përshkroi sistemin gjyqësor se ka bërë progres në ndjekjen e veprave të rënda penale, duke përfshirë terrorizmin, krimet e luftës, dhe krimin e organizuar, dhe se i kishte zhvilluar kapacitetet për t'i trajtuar krimet serioze dhe çështjet e ndjeshme ndëretnike gjyqësore. Sipas UNMIK-ut, periudha karakterizohej nga një tendencë stabilizuese në situatën e krimit dhe në përgjithësi në zvogëlimin e krimeve të rënda.

## **Pasojat e "trazirave të Marsit të vitit 2004"**

Trazirat që ndodhën në tërë teritorin e Kosovës më 17 dhe 18 mars 2004 u përshkruan si një ngecje serioze për stabilizimin dhe normalizimin e Kosovës. Duke vazhduar me implementimin e standardeve dhe luftimin e krimeve të rënda (krimet e luftës, krimet ndër-etnike dhe krimin e organizuar), UNMIK-u ngriti si prioritet të lartë hetimin dhe ndjekjen e kryesve të trazirave. Përderisa prokurorët dhe gjyqtarët ndërkombëtarë drejtonin procesin, gjyqësia vendëse ishte gjithashtu e përfshirë gjithnjë e më shumë, pavarësisht raportimeve në lidhje me presionin e madh që ushtrohej ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve vendor. Megjithatë, me gjithë përfshirjen e gjyqësorit vendor në ndjekjen penale dhe gjykimin e kryesve të trazirave, OSBE-ja në Dhjetor të vitit 2005 erdhi në përfundim se gjyqësori në Kosovë kishte dështuar të dërgojë një mesazh të qartë popullatës për dënimin e dhunës. UNMIK-u poashtu u ankua se udhëheqësit lokal dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile kishin dështuar në masë të madhe t'i përkrahnin veprimet e UNMIK-ut për të mbështur sundimin e ligjit. Si rezultat i trazirave, strukturat e gjykatave paralele në Veri të Kosovës kishin rifilluar operacionet e tyre edhe pse ata kishin pushuar së funksionuari pak para Marsit të vitit 2004. Në përgjigje, UNMIK-u ka shtuar përpjekjet për të lehtësuar qasjen në drejtësi për serbët e Kosovës me hapjen e zyrave ndërlidhëse të gjykatave shtesë në zonat e Kosovës të banuara me shumicë serbë. Numri i serbëve të involvuar në sistemin e drejtësisë mbeti relativisht i ulët.

Në shkurt të vitit 2005, UNMIK-u për herë të parë raportoi në lidhje me problemin e lëndëve të grumbulluara në gjykimin dhe ekzekutimin e lëndëve gjyqësore. Që nga ajo kohë, kjo temë mbeti si prioritet në agjendën e UNMIK-ut edhe pse numri i rasteve rritej vazhdimisht përgjatë viteve në vijim. Kërcënimet e vazhdueshëm të dëshmitarëve dhe punonjësve të sistemit të drejtësisë edhe më tutje vazhduan të paraqesin pengesë serioze për vendosjen e sundimit të ligjit në Kosovë.

Megjithatë, "trazirat e marsit", si duket kishin përshpejtuar procesin e transferimit të përgjegjësive në sektorin e drejtësisë nga UNMIK-u tek IPVQ-të. Deri në fund të vitit 2004, UNMIK-u kishte ndërmarrë një rishikim të plotë të kompetencave të veta nën Rezolutën 1244 dhe kishte identifikuar një numër të madh të përgjegjësive që nuk ndërhynin në sovranitet dhe mund të ju transferoheshin IPVQ-ve. Si rezultat i shqyrtimit të tillë, Ministria e Drejtësisë është themeluar në Dhjetor të vitit 2005, si pjesë e Qeverisë së IPVQ. Ministria e Drejtësisë ishte përgjegjëse për aktivitetet vijuese:

- Hartimi i politikave brenda fushës së përgjegjësive të saj, për të lehtësuar përgatitjen dhe zbatimin e legjislacionit në fushën e drejtësisë, duke përfshirë prokurorinë publike, megjithëse duke përjashtuar çështjet që lidhen me administrimin e gjyqësorit dhe të gjykatave;
- Menaxhimi i çështjeve administrative, financiare dhe buxhetore të Ministrisë, dhe zhvillimin e rregullave administrative, teknike dhe financiare dhe rregullat e qeverisjes së personelit ndihmës dhe burimet materiale për funksionim efektiv të sistemit të prokurorisë, pa ndërhyrë në asnjë mënyrë në veprimet e Zyrës së Prokurorit Publik dhe në zbatimin e hetimeve penale;
- Siguron udhëzime në lidhje me zhvillimin dhe zbatimin e politikave prokurorjale të Zyrës së Prokurorit Publik të Kosovës, pa ndërhyrë fare në veprimet e Zyrës së Prokurorit Publik dhe në zbatimin e hetimeve penale;
- Të ofrojë trajnime, duke përfshirë trajnimin profesional dhe aftësimin e prokurorëve, në bashkëpunim me Institutin Gjyqësor të Kosovës;
- Organizimin e provimeve për kualifikimin e prokurorëve, avokatëve dhe ekspertëve të tjerë ligjorë nëpërmjet Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe të organeve të tjera të pavarura profesionale;
- Sigurimi i koordinimit për çështjet që kanë të bëjnë me shërbimin korrektues;
- Bashkëpunon me organizatat përkatëse në lidhje me monitorimin e pavarur të sistemit të prokurorisë dhe shërbimit korrektues;
- Të sigurohet informacion dhe statistika mbi shërbimin korrektues dhe sistemin e prokurorisë;
- Të sigurojë mbrojtje të të dhënave personale në lidhje me shërbimin korrektues dhe sistemin e prokurorisë;
- Të sigurohet bashkëpunim në çështjet korrektuese me subjektet përkatëse brenda Kosovës;
- Ndihton në punësimin, përgatitjen dhe vlerësimin e personelit të shërbimit korrektues;
- Hartimi dhe zbatimi i politikave për të ju siguruar qasje të drejtë dhe efektive pjesëtarëve të të gjitha komuniteteve në sistemin gjyqësor;
- Të i sigurojë ndihmë viktimave të krimit, dhe në veçanti viktimave të dhunës në familje dhe të trafikimit të qenieve njerëzore, dhe mbikëqyrë zyrën e Koordinatorit për Ndhmë të Viktimave;

- I ofron ndihmë UNMIK-ut sipas nevojës në ushtrimin e përgjegjësisë për bashkëpunim ndërkombëtar juridik, duke përfshirë bashkëpunimin me Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Gjykatën Penale Ndërkombëtare dhe Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë;
- Përfaqëson Qeverinë në konteste dhe procedura para gjykatave dhe tribunaleve të arbitrazhit;
- Ofrimi i mbështetjes profesionale për përgatitjen e marrëveshjeve nga Qeveria në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Përgjegjësitë e transferuara në IPVQ kanë qenë përgjithësisht "përgjegjësi të buta" dhe subjekt i një rishikimi të përkohshëm të performancës fillestare të Ministrisë së Drejtësisë. Me një rezultat pozitiv të këtij shqyrtimit, PSSP-ja do të i caktojë kompetencat shtesë Ministrisë së Drejtësisë.

Përveç Ministrisë së Drejtësisë, UNMIK-u themeloi në Dhjetor të vitit 2005, Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) duke operuar nën autoritetin e PSSP-së dhe duke trashëguar Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës. KGJK përbëhet nga 11 anëtarë, prej të cilëve 7 ishin gjyqtarë (duke përfshirë 2 gjyqtarë ndërkombëtarë) dhe 4 anëtarë tjerë të cilët nuk ishin gjyqtarë. Gjyqtarët përfshinin Kryetarin e Gjykatës Supreme, 2 gjyqtarë nga Gjykata Supreme dhe 4 gjyqtarë tjerë që përfaqësonin gjykatat tjera. Në mesin e 7 posteve të rezervuara për gjyqtarë, 2 ishin të zënë nga prokurorët, njëri prej tyre ishte prokuror ndërkombëtar, deri në kohë kur do themelohej një organ përgjegjës për këshillimin e PSSP-së lidhur me çështjet e emërimit, disiplinimit dhe shkarkimit të prokurorëve. Anëtarët e tjerë të KGJK-së ishin Ministri i Drejtësisë, Kryetari i Komisionit Parlamentar për Legjislacion, Çështjet Gjyqësore dhe të Kornizës Kushtetuese, Kryetari i Odës së Avokatëve të Kosovës, dhe një profesor i së drejtës. Kryetari i Gjykatës Supreme ishte kryetari i KGJK-së.

Përderisa PSSP-ja mbajti autoritetin përfundimtar lidhur me emërimin dhe shkarkimin nga detyra të gjyqtarëve, KGJK-ja ishte përgjegjëse për:

- Përcaktimin e politikave administrative dhe sigurimin e mbikëqyrjes administrative për gjyqësinë dhe gjykatat;
- Vendosjen e politikave dhe shpalljen e rregullave dhe udhëzimeve për gjyqësinë dhe gjykatat duke përfshirë rekrutimin, trajnimin dhe emërimin, vlerësimin, promovimin, transferimin dhe disiplinën të gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë si dhe tëpersonelit tjetër gjyqësor dhe jo-gjyqësor;
- Ushtrimin e përgjegjësive në lidhje me organizimin dhe funksionimin e rregullt të gjykatave;
- Vendosjen e vendndodhjes gjeografike, numrin dhe strukturën e gjykatave në konsultim me Kuvendin e Kosovës;
- Ushtrimin e përgjegjësive në lidhje me sigurimin e kërkesave teknike dhe financiare, personelit mbështetës dhe burime materiale për të siguruar funksionim efektiv të sistemit gjyqësor;
- Krijimi i politikave dhe ofrimi i trajnimeve për personelin gjyqësor, duke përfshirë trajnimin profesional dhe ngritjes së aftësive, në bashkëpunim me Gjykatën Supreme të Kosovës, në tërësi ose pjesërisht me anë të Institutit Gjyqësor të Kosovës ("IGJK-ja");
- Ushtrimin e përgjegjësive në lidhje me organizimin e provimeve për kualifikimin e gjyqtarëve nëpërmjet IGJK-së;

- Ushtrimin e përgjegjësive në lidhje me emërimin, trajnimin, disiplinimin dhe largimin e anëtarëve të personelit ndihmës gjyqësor;
- Sipas nevojës sigurimi i informacionit dhe statistikave për sistemin gjyqësor, duke përfshirë bashkëpunimin me organizatat përkatëse sa i përket monitorimit të pavarur të sistemit gjyqësor, dhe
- Mbrojtja e të dhënave personale lidhur me sistemin gjyqësor.

Lidhur me zgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve, KGJK-ja kishte për obligim të shqyrtonte kërkesat e kandidatëve dhe të i bënte rekomandime PSSP-së për emërim të kandidatëve. KGJK gjithashtu ishte e ngarkuar për të krijuar një Komisioni Disiplinor Gjyqësor me qëllim të inicimit dhe zgjidhjes së çështjeve të shkallës së parë që kanë të bëjnë me dyshime në lidhje me sjelljet së pahijshme të gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë dhe për përcaktimin e sanksioneve të duhura, në rast se rezultojë se janë bërë sjellje të pahijshme. Çdo ankesë do duhej t'i referohej Njesisë së Inspektimit Gjyqësor për hetim, njësit ky i cili pas përfundimit të hetimit, do të përcaktojë nëse akuzat duhet të dorëzohet në Komisionin Disiplinor Gjyqësor. Komisioni Disiplinor Gjyqësor pastaj do të vendosë lidhur me sanksionet disiplinore, me ç'rast përveç shkarkimit të gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë nga zyra, do mund të rekomandojë PSSP-së shkarkime të gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë.

## **Bisedimet për Statusin**

Pas një shqyrtimi të plotë të procesit të standardeve gjatë vitit 2005, Këshilli i Sigurimit në Tetor të atij viti vendosi të fillojë një proces politik të dizajnuar për të përcaktuar statusin e ardhshëm të Kosovës. Në Nëntor të vitit 2005, Këshilli i Sigurimit emëroi Martti Ahtisaari të dërguarin special të Sekretarit të Përgjithshëm për udhëheqjen e procesit të zgjedhjes së statusit të ardhshëm i cili moderoi disa raunde bisedimesh ndërmjet përfaqësuesve të Kosovës dhe Serbisë në muajt pasues.

Gjatë kësaj periudhe, aktivitetet që lidhen me organizimin e sistemit gjyqësor u intensifikuan. Në prill të vitit 2006, PSSP-ja shpalli një rregullore mbi kornizën rregullative për sistemin gjyqësor në Kosovë që obligonte marrjen e masave për të rekrutuar më shumë gjyqtarë dhe prokurorë nga komunitetet jo mirë të përfaqësuar dhe rritjes së aksesit në drejtësi për të gjitha komunitetet nëpërmjet krijimit të zyrave ndërlidhëse të gjykatave, gjykatave komunale dhe gjykatave për kundërvajtje në zonat e karakterizuara nga izolimi gjeografik, mungesa e sigurisë dhe faktorët tjerë relevant. Kjo në fakt iu referua kryesisht zonave të banuara me shumicë prej pjestarëve nga komuniteti Serb në Kosovë. U dizajnuar pragu i themeluar për angazhimin e komuniteteve pakicë në sistemin gjyqësor, duke kërkuar që 15% e gjyqtarëve dhe prokurorëve të jenë nga komuniteti jo-shqiptarë i Kosovës, përderisa 8% e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve kërkohej që t'i përkisnin komunitetit serb të Kosovës. Tani e tutje, masat për rritjen e përfaqësimit të komunitetit pakicë në sistemin gjyqësor dhe lehtësimi i aksesit në drejtësi u bënë një element kyç i politikës së sektorit gjyqësor të UNMIK-ut. Rregullorja poashtu parashikonte që gjyqtarët ndërkombëtar të vendosin në ankesat ku besohet që paragjykimet etnike të kenë ndikuar në marrje të vendimeve. Ndoshta më e rëndësishmja është që rregullorja vuri themelet për një reformë gjyqësore duke paraparë themelimin e një Komisioni të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial për të administruar procesin e riemërimit gjyqësor dhe prokurorial. Përgatitjet për një procedurë të plotë të reformimit gjyqësor dhe prokurorial janë vënë në lëvizje me përfshirje thelbësore të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës në financimin dhe zbatimin e procesit të rishikimit.

Së bashku me këto masa, PSSP-ja i transferoi në Prill të vitit 2006 më tepër përgjegjësi Ministrisë së Drejtësisë, ku përfshihen përgjegjësitë për:

- Hartimin e politikave brenda fushës së përgjegjësi të saj, për të lehtësuar përgatitjen dhe zbatimin e legjislacionit në fushën e drejtësisë, duke përfshirë prokurorinë publike, duke përjashtuar çështjet që lidhen me administrimin e gjyqësorit dhe të gjykatave;
- Menaxhimin e çështjeve administrative, financiare dhe buxhetore të Ministrisë, dhe zhvillimin e rregullave administrative, teknike dhe financiare dhe rregullat e personelit ndihmës dhe burimet materiale për funksionim efektiv të sistemit të prokurorisë, pa ndërhyrë në asnjë mënyrë në veprimet e Zyrës së Prokurorit Publik dhe në zbatimin e hetimeve penale;
- Siguron udhëzime në lidhje me zhvillimin dhe zbatimin e politikës së prokurorisë së Zyrës së Prokurorit Publik të Kosovës, pa ndërhyrë në asnjë mënyrë në veprimet e Zyrës së Prokurorit Publik dhe në zbatimin e hetimeve penale;
- Ofron trajnime, duke përfshirë trajnimie profesionale dhe aftësimin e prokurorëve përmes Institutit Gjyqësor të Kosovës;
- Organizimi i provimeve për kualifikimin e prokurorëve, avokatëve (duke përfshirë edhe përfaqësuesit ligjor) dhe ekspertët tjerë ligjor përmes Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe organeve të tjera të pavarura profesionale;
- Të sigurohet informacion dhe statistika mbi të gjitha veprimtaritë e kryera nën autoritetin e Ministrisë, duke siguruar mbrojtjen e të dhënave personale;
- Ushtrimi i mbikëqyrjes ekzekutive mbi shërbimin korrektues dhe shërbimin e provës, përveç se në situata të jashtëzakonshme UNMIK do të mbajë dhe të ushtrojë autoritetin në burgun e Dubravës për të komanduar dhe kontrolluar të gjitha operacionet;
- Hartimi dhe zbatimi i politikave për të siguruar qasje të drejtë dhe efektive pjesëtarëve të të gjitha komuniteteve në sistemin e drejtësisë;
- Ushtrimi i përgjegjësisë për kërkim, marrje, sigurim dhe verifikim të informatave në lidhje me vendndodhjen dhe fatin e personave të zhdukur, dhe kthimin e mbetjeve mortore të personave të zhdukur, duke shfrytëzuar ndihmën dhe ekspertizën e personelit të Zyrës për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore dhe specialistëve të tjerë, subjekt i autoritetit të UNMIK-ut mbi të gjitha hetimet e rasteve individuale të zhdukjes;
- Ushtrimi i përgjegjësisë për çështjet që kanë të bëjnë me mjekësinë ligjore duke përfshirë edhe administrimin e Zyrës për Ekzaminim Mjekësor, subjekt i mbikëqyrjes së UNMIK-ut mbi çertifikimin e kërkuar dhe trajnimin e personelit të Zyrës për Ekzaminim Mjekësor dhe përputhjen e tyre me standardet ndërkombëtare. UNMIK-u do të mbajë kontroll të drejtpërdrejtë mbi të gjitha Ekzaminimet mjeko-ligjore dhe raportet e ekspertëve lidhur me çështjet penale nën përgjegjësinë e prokurorëve ndërkombëtarë, duke përfshirë edhe rastet e krimit të organizuar, krimit kundër pakicave etnike, terrorizmin dhe trafikimin e personave;
- Të sigurojë ndihmë për viktimat e krimit, dhe në veçanti viktimat e dhunës në familje dhe të trafikimit të qenieve njerëzore si dhe të mbikëqyrë zyrën e Koordinatorit për Ndihmë të Viktimave;

- Të asistojë UNMIK-un kur është e nevojshme në ushtrimin e përgjegjësisë së tij për ndihmë juridike ndërkombëtare dhe bashkëpunim, duke përfshirë bashkëpunimin me Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Gjykatën Ndërkombëtare Penale dhe Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë;
- Përfaqëson Qeverinë në konteste dhe procedura para gjykatave dhe tribunaleve të arbitrazhit, dhe
- Ofron mbështetje profesionale për përgatitjen e marrëveshjeve në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar nga ana e qeverisë.

Ministria e Drejtësisë gjithashtu mori përsipër autoritetin për punësimin e stafit tjerë jashtë ndërkombëtarëve të angazhuar nga ana e Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut pagat e të cilëve paguheshin nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe përgjegjësitë e të cilëve ranë në kuadër të kompetencave që ishin transferuar në Ministrinë e Drejtësisë.

Si një masë shtesë për të rritur qasjen në drejtësi, UNMIK-u në Qershor të vitit 2006 themeloi sistemin e ndihmës ligjore që menaxhohej nga një organizatë e pavarur - Komisioni për Ndihmë Juridike dhe Komisioneri i saj i emëruar nga Kryeministri. UNMIK-u vlerësoi sistemin e ndihmës juridike, si të parën agjenci të ndihmës juridike "të financuar nga shteti" në Ballkan.

Në fushën e drejtësisë penale, UNMIK-u në Shtator të vitit 2006 themeloi Zyren e Prokurorisë Speciale të Kosovës (ZPSK) si një njësi përbërëse e Divizionit Penal të Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut. ZPSK përbëhej nga prokurorë ndërkombëtar dhe lokal të caktuar nga PSSP-ja. ZPSK ishte përgjegjëse për ndërtimin e kapaciteteve në Zyrën e Prokurorit Publik përmes trajnimit dhe këshillimit të Prokurorëve Special me qëllim të rritjes së aftësisë së tyre për të ndjekur penalisht veprat më të rënda penale në Kosovë. Megjithatë, ZPSK kishte poashtu juridiksionin në krimet më të rënda në Kosovë, duke përfshirë por jo kufizuar në rastet e krimit të organizuar, korrupsionit, veprave penale të motivuara nga pikëpamjet raciale, përkatësia nacionale, etnike, apo fetare, terrorizmit dhe trafikimit të qenieve njerëzore. Prokurorët special që punonin brenda ZPSK nën mbikqyrjen apo monitorimin e prokurorëve ndërkombëtarë ishin të autorizuar të kryenin funksionet e tyre në të gjitha gjykatat në tërë Kosovën. ZPSK u operacionalizua në Qershor të vitit 2007. Përveç krijimit të ZPSK, nga mesi i vitit 2007 të gjitha gjykatat e qarkut u pajisen, me mbështetje të Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara, me sistem për mbrojtjen e dëshmitarëve që do të përmirësonte aftësinë e sistemit gjyqësor të Kosovës për të kryer hetime dhe ndjekje penale në rastet e ndjeshme me dëshmitarë të mbrojtur.

Në Dhjetor të vitit 2006, pas përgatitjeve të gjata dhe ende në pritje të marrëveshjeve përfundimtare për financimin dhe zbatimin e tij, PSSP-ja themeloi Komisionin e Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial (KPGJP) si organ i pavarur i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), me qëllim të shqyrtimit të përnjëhershëm dhe gjithëpërfshirës në mbarë Kosovën të përshtatshmërisë së të gjithë kandidatëve për emërim të përhershme në postin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Kosovë. Procesi i emërimit, do të organizohej në tri faza të njëpasnjëshme:

- Faza 1: Përzgjedhja e gjyqtarëve për Gjykatën Supreme të Kosovës dhe të prokurorëve publikë për Zyrën e Prokurorit Publik të Kosovës;
- Faza 2: Përzgjedhja e gjyqtarëve për Gjykatën e Qarkut, Gjykatën Ekonomike dhe Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje dhe prokurorëve publikë për Zyrat e Prokurorëve Publik të Qarkut, dhe
- Faza 3: Përzgjedhja e gjyqtarëve për Gjykatat Komunale dhe Gjykatat Komunale për Kundërvajtje dhe prokurorët publikë për Zyrat Komunale të Prokurorëve Publik.

Pas përfundimit të procesit të verifikimit, KPGjP-ja do të bëjë rekomandime me shkrim mbi kandidatët për secilën Zyre Gjyqësore dhe Prokuroriale në Kosovë të KGJK-së për dorëzim më pas tek PSSP në pajtim me Kornizën Kushtetuese.

Si një nga masat e fundit legislative të ndërmarra nga UNMIK-u pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, PSSP-ja themeloi në Qershor të vitit 2008 Zyren e Këshillit Disiplinor dhe Njësinë Gjyqësore të Auditimit në kuadër të Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut, e cila trashigoi ish-Njësinë e Inspeksionit Gjyqësor. Zyra e Këshillit Disiplinor ishte përgjegjëse për:

- Hetimin e aktiviteteve të gjyqtarëve, prokurorëve dhe gjyqtarëve porotë që punojnë në sistemin gjyqësor dhe të prokurorisë, pavarësisht nëse ato kanë qenë subjekt i një ankese;
- Paraqitjen e rasteve të sjelljes së pahijshme para organve përkatëse disiplinore gjyqësore dhe prokuroriale; dhe
- Hetimin e ankesave të bëra kundër një gjyqtari, prokurori ose gjyqtari porot.

Me vendim të PSSP-së, Zyra e Këshillit Disiplinor do të transferohej në Komisionin e Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial dhe do të mbetet aty deri në përfundim të procesit të verifikimit.

Njësia e Auditimit të Gjyqësorit ishte përgjegjëse për analizimin dhe vlerësimin e funksionimit të gjykatave dhe zyrave të prokurorive publike dhe për analizimin dhe vlerësimin e veprimtarive të veçanta gjyqësore apo prokuroriale me qëllim të propozimit të reformave për aktivitete të tilla.

Përkundër të gjitha këtyre masave, të përshkruara nga UNMIK-u si hapa progresivë për forcimin e sistemit të drejtësisë, UNMIK-u u bë më kritik ndaj sistemit të drejtësisë. UNMIK-u pohoi se ishte ende e nevojshme që gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtarë të trajtonin çështjet më delikate. Sistemi i drejtësisë do të vuajë nga burimet e pamjaftueshme, që kishte një ndikim negativ në motivimin e gjyqtarëve dhe kapacitetin për të tërhequr profesionistët juridik për të shërbyer në sistemin gjyqësor. UNMIK-u poashtu ishte i zhgënjyer me sistemin gjyqësor për sa i përket hetimit dhe ndjekjes penale të kryerësve të trazirave të Marsit, duke kritikuar në fund të vitit 2006 se nuk është bërë një progres i konsiderueshëm. U ngritën shqetësime edhe në lidhje me ngarkesën në rritje të rasteve duke kritikuar se zbatimi i menaxhimit të çështjeve në sistemin e informacionit, që ishte dizajnuar për të ndihmuar në uljen e rasteve të pazgjidhura, ishte në mënyrë të konsiderueshme pas afatit.

## SISTEMI I DREJTËSISË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

### **Sistemi i Drejtësisë në kuadër të Kushtetutës së Republikës së Kosovës – Pasqyrimi**

Pas disa raundeve të bisedimeve ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, të cilat përfunduan pa ndonjë zgjidhje kompromisi të statusit të Kosovës, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së në Prill të vitit 2007 dorëzoi në Këshillin e Sigurimit “Raportin Gjithpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës” (në vijim “marrëveshja gjithpërfshirëse”), dokument ky i cili ishte përparim nga i dërguari special i Sekretarit të

Përgjithshëm Martti Ahtisaari, ku propozoi si zgjidhje të vetme të mundshme pavarësimin e Kosovës të mbikqyrur për një periudhë të caktuar nga komuniteti ndërkombëtarë. Pasi që marrëveshja gjithpërfshirëse nuk mund të aprovohej nga ana e Këshillit të Sigurimit, më 17 Shkurt 2008 Kuvendi i Kosovës shpalli pavarësinë e Republikës së Kosovës në pajtim të plotë me këtë marrëveshje. Në Prill të vitit 2008, Kuvendi miratoi Kushtetutën e Republikës së Kosovës e cila hyri në fuqi me 15 Qershor 2008.

Kushtetuta njohi supremacinë e marrëveshjes gjithpërfshirëse në forma të ndryshme. Sipas Kushtetutës, të gjitha autoritetet në Republikën e Kosovës duhet të i marrin përsipër obligimet të cilat dalin nga raporti i Z. Ahtisaari dhe duhet po ashtu të ndërmirren të gjitha masat për implementimin e këtij raporti. Dispozitat e marrëveshjes gjithpërfshirëse kanë supremaci me të gjitha dispozitat tjera ligjore në Kosovë. Kushtetuta, ligji dhe aktet tjera ligjore të Republikës së Kosovës duhet të interpretohen në pajtim me marrëveshjen gjithpërfshirëse. Nëse vërehet mungesë harmonie në mes të dispozitave Kushtetuese, ligjeve apo dokumenteve tjera ligjore të Republikës së Kosovës me dispozitat e Raportit Gjithpërfshirës, atëherë vendoset në bazë të këtij të fundit.

Për sa i përket sistemit gjyqësor, Raporti Gjithpërfshirës ndër të tjera ofron bazën juridike për:

- Themelimin e Gjykatës Kushtetuese;
- Gjykatësit dhe prokurorët të emërohen dhe shkarkohen nga ana e Presidentit të Kosovës vërtet në bazë të prozimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës, përbërja e të cilit është përcaktuar nga marrëveshja gjithpërfshirëse, të ketë pavarësi të plotë në ushtrimin e funksioneve të tij me qëllim të sigurimit të një sistemi gjyqësor i cili gëzon integritet, pavarësi, profesionalizëm dhe të drejtë, duke ju mundësuar qasje të gjithë personave në Kosovë në organet e drejtësisë dhe duke garantuar që sistemi i drejtësisë në Kosovë të jetë gjithpërfshirës dhe të reflektoj natyrën shumë-etnike të Kosovës;

Gjykata Kushtetuese është themeluar si gjykatë e pavarur dhe si autoritet përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës dhe pajtueshmërisë së dokumenteve tjera ligjore me Kushtetutë. Gjykata Kushtetuese përbëhet nga nëntë (9) gjyqtarë të emëruar nga Presidenti i Republikës së Kosovës në bazë të propozimeve paraprake të Kuvendit.

Sipas Kushtetutës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës është përgjegjës për ndërmarrjen e inspektimeve gjyqësore, administrimin e gjyqësisë, zhvillimin e rregullave gjyqësore në pajtim me ligjin, punësimin dhe mbikëqyrjen e administruesve të gjykatave, zhvillimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit të gjyqësorit, përcaktimin e numrit të gjyqtarëve në secilin juridiksion dhe dhënja e rekomandimeve për themelimin e gjykatave të reja. Ky Këshill është i përbërë nga 13 anëtarë të zgjedhur sipas kësaj rënditjeje:

- Pesë (5) anëtarë do të jenë gjyqtarë të zgjedhur nga anëtarët e gjyqësorit;
- Katër (4) anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet e fituara gjatë ndarjes së përgjithshme të vendeve. Të paktën dy (2) nga katër (4) anëtarët duhet të jenë gjyqtarë, dhe një (1) do të jetë anëtar i Odës së Avokatëve të Kosovës;
- Dy (2) anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komunitetit Serb në Kosovë, dhe të paktën njëri prej këtyre të dyve, duhet të jetë gjyqtar;



- Dy (2) anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve të tjera, dhe të paktën njëri prej këtyre të dyve, duhet të jetë gjyqtar;

Megjithatë, gjatë kohëzgjatjes së mandatit të Prezencës Ndërkombëtare Civile, Këshilli Gjyqësor është i përbërë si në vijim:

- Pesë (5) anëtarë janë anëtarë kosovarë të Komisionit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial, që janë verifikuar nga Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial, si pjesë e fazës së parë dhe të dytë të procesit të emërimit,
- Tetë (8) anëtarët e tjerë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës do të zgjedhen nga Kuvendi i Kosovës në mënyrën e përcaktuar me këtë Kushtetutë, përveç dy (2) nga katër (4) anëtarët e zgjedhur nga deputetët e Kuvendit që mbajnë vende të fituara gjatë ndarjes së përgjithshme të vendeve, duhet të jenë ndërkombëtarë, të përzgjedhur nga Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil, sipas propozimit të Misionit Evropian për Politika të Sigurisë dhe Mbrojtjes. Njëri nga anëtarët ndërkombëtarë duhet të jetë gjyqtar.

Ashtu sikurse është kërkuar nga marrëveshja gjithëpërfshirëse, Kushtetua përcakton si në vijim:

- Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovës ushtrohet nga gjykatat;
- Pushteti gjyqësor është i veçantë, i pavarur, i drejtë, jopolitik dhe i pa-anshëm si dhe siguron qasje të barabartë nëpër gjykata;
- Gjykatat veprimtarinë e tyre e ushtrojnë në pajtim me Kushtetën dhe ligjin, dhe
- Gjykatësit janë të pavarur dhe të pa-anshëm në ushtrimin e funksionit të tyre;

Përsa i përket organizimit të gjykatave, Kushtetuta përmend në mënyrë eksplicite vetëm Gjykatën Supreme dhe Gjykatën Kushtetuese, duke lënë hapsirë që organizimi i gjykatave të përcaktohet me ligj të veçantë.

Kushtetuta kërkon që gjithëpërfshirja dhe shqyrtimi në mbarë Kosovën në lidhje me përshtatshmërinë e të gjithë kandidatëve për emërim të përhershme në pozitën e gjyqtarëve dhe prokurorëve publik në Kosovë të vazhdon të kryhet në përputhje me rregullat e përcaktuara nga UNMIK-u dhe që një gje e tillë nuk do të ndikohet nga përfundimi i mandatit UNMIK-ut ose nga hyrja në fuqi e Kushtetutës. Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial (KPGjP) parashtron rekomandimin e kandidatëve për emërim apo ri-emërimin në pozitën e gjykatësve apo prokurorëve në formë të shkruar tek Këshilli Gjyqësor i Kosovës, i cili do të ushtrojë autoritetin përfundimtar për propozimin e këtyre kandidatëve për emërim apo ri-emërim para Presidentit të Kosovës. Ligji për Përbërjen e Përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, i shpallur në Janar 2009, i jep kompetenca Presidentit të Kosovës që të i emëroj të gjithë anëtarët e KPGjP-së, përfshirë edhe anëtarët ndërkombëtar dhe po ashtu Panelin Rishikues të KPGjP-së.

Përveç Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Kushtetuta njih po ashtu Prokurorin Shtetëror si institucion të pavarur me mandat dhe përgjegjësi për të përndjekur penalisht personat e akuzuar për kryerjen e veprave kriminale dhe akteve tjera të specifikuar me ligj. Kushtetuta parasheh edhe themelimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, funksionet e të cilit janë që të garantoj që Prokuroria Shtetërore të jetë e pavarur, profesionale dhe e pa-anshme si dhe të reflektoj natyrën multi-etnike të Kosovës dhe parimet e barazisë gjinore. Këshilli Prokurorial i Kosovës duhet të rekrutoj, propozoj, promovoj, transferoj, ri-emëroj dhe disciplinoj prokurorët ashtu sikurse është e paraparë me ligj.

## Reforma e Sistemit të Drejtësisë

Kushtetuta specifikon hyrjen në fuqi të legjislacionit dhe përputhshmërinë me provizionet e saj, derisa të mos shfuqizohet, zëvendësohet ose të ndryshohet në pajtim me këtë Kushtetutë. Pasi që të gjitha rregulloret dhe udhëzimet administrative të UNMIK-ut vazhduan të aplikohen, u shtrua si domosdoshmëri të zëvendësohen ato në mënyrë që të sigurohet përputhshmëria institucionale e rregullative e sistemit të drejtësisë me Kushtetutën.

Njëra ndër masat e para legjislative pas shpalljes së pavarësisë ishte themelimi i Zyrës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës si zyrë e përhershme dhe e specializuar prokuroriale që operon nën ombrellën e Zyrës së Prokurorit të Shtetit të Kosovës. Kjo zyrë është paraparë të ketë dhjetë prokurorë publik të Kosovës dhe prokurorë shtesë sipas nevojës. Për më shumë, kjo zyrë do të përbëhej prej pesë prokurorëve të EULEX-it gjatë kohëzgjatjes së pranisë së misionit ndërkombëtar në Kosovë. Prokurorët special kanë autoritet dhe përgjegjësi të bëjnë hetimin e veprave penale duke u fokusuar në rastet që janë në fushëveprim të saj, në të gjitha zryet e prokurorisë apo gjykatat në gjithë territorin e Kosovës.

Një ndër të arriturat për fuqizimin e kornizës institucionale të shërbimit të prokurorisë publike ishte themelimi i Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe rregullimi i funksioneve të Prokurorit të Shtetit në Tetor 2010. Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Prokurorial të Kosovës përfshijnë si më poshtë:

- të siguruarit që prokurorët veprojnë në mënyrë të pavarur, profesionale dhe të paanshme gjatë kryerjes së të gjitha funksioneve prokuroriale;
- rekrutimin dhe propozimin tek Presidenti të kandidatëve për emërim dhe rrimërim në prokurori, përfshirë kandidatët nga komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë;
- të siguruarit se prokuroritë pasqyrojnë përbërjen etnike të zonës së tyre të juridiksionit;
- propozimi i kandidatëve tek Presidenti për emërim si Kryeprokuror të Shtetit;
- në bashkëpunim në Institutin Gjyqësor të Kosovës, themelon standardet për rekrutimin, organizimin dhe shpalljen e provimit përgatitor për kualifikimin e prokurorëve;
- përcaktimin e numrit të prokurorëve për secilën prokurori;
- emërimin e Kryeprokurorëve për Prokuroritë Themelore dhe Prokurorisë së Apelit, në përputhje me Ligjin mbi Prokurorinë e Shtetit;
- në bashkëpunim me Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit zhvillon politikat dhe strategjitë prokuroriale për luftimin efektiv të kriminalitetit;
- i propozon Qeverisë dhe Kuvendit masat lidhur me sistemin prokurorial dhe për luftimin e kriminalitetit;
- raportimi tek Kuvendi i Kosovës, Presidenti dhe publiku mbi punën e Këshillit dhe të Prokurorisë së Shtetit;
- mbikëqyrë administrimin e prokurorive dhe personelit të saj;
- përgatitjen, dërgimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit të sistemit prokurorial për të siguruar funksionim efikas dhe efektiv të prokurorive dhe kontabilitetit për përdorimin e burimeve fiskale;
- përcaktimin e procedurave për seancat dhe zhvillimin e seancave disiplinore.

Këshilli Prokurorial i Kosovës është i përbërë nga 9 anëtarë që janë qytetarë të Republikës së Kosovës, 5 prej të cilëve janë prokurorë. Pesë prokurorët anëtarë të Këshillit përfshijnë:

- Kryeprokurorin e Shtetit;

- një (1) prokuror nga Prokuroria Speciale që zgjidhet nga prokurorët që shërbejnë në atë zyrë;
- një (1) prokuror nga Prokuroria e Apelit që zgjidhet nga prokurorët që shërbejnë në atë zyrë, dhe
- dy (2) prokurorë nga Prokuroria Themelore që zgjidhen nga prokurorët që shërbejnë në atë zyrë.

Anëtarët jo-prokurorë të Këshillit janë:

- një (1) anëtar nga Oda e Avokatëve të Kosovës i cili ka specializuar në të drejtën penale, me anë të propozimit të Këshillit Ekzekutiv të Odës së Avokatëve;
- një (1) profesor nga fakultetet juridike të Republikës së Kosovës sipas propozimit të Departamentit për Arsim të Lartë apo të autoritetit relevant që lidhet me arsimin e lartë;
- një (1) përfaqësues nga shoqëria civile me përgatitje të lartë profesionale dhe me njohuri nga fusha e të drejtave të njeriut.

Ministri i Drejtësisë është anëtar i Këshillit ex officio.

Me themelimin e Këshillit, detyrat dhe përgjegjësitë lidhur me prokurorinë publike që ushtroheshin më herët nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës u bartën te Këshilli Prokurorial i Kosovës. Kryetari i Republikës së Kosovës emëron dhe shkarkon prokurorët bazuar në rekomandimin e Këshillit.

Brenda Këshillit ekziston Komisioni Diciplinor i cili përbëhet nga tre (3) anëtarë të Këshillit, dy (2) prej të cilëve janë prokurorë. Komisioni diciplinor inicon masa dicipline kundër prokurorëve bazuar në hetimet e bëra të Zyrës së Prokurorit Diciplinor. Kjo zyrë është themeluar si organ i pavarur që i shërben Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës. Sa i përket sistemit prokurorial, Zyra e Prokurorit Diciplinor është përgjegjëse për hetimin e shkeljeve nga ana e prokurorëve duke prezentuar evidencë dhe dosjen dicipline për shkelje tek komisioni diciplinor.

Prokurori i Shtetit organizohet në prokuroritë si në vijim:

- Prokuroria Themelore e përbërë nga Departamenti i Përgjithshëm, nga Departamenti për të Mitur dhe nga Departamenti për Krime të Rënda;
- Prokuroria e Apelit e përbërë nga Departamenti i Përgjithshëm dhe Departamenti për Krime të Rënda i Prokurorisë;
- Prokuroria Speciale; dhe
- Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit,

Në mënyrë që të zbatohet struktura e re e prokurorisë publike, është paraparë ky orar i zbatimit:

- Faza planifikuese: Nga 1 Janari 2011 deri 31 Dhjetor 2011 Këshilli Prokurorial i Kosovës duhet të përgatisë planin implementues për lehtësimin e tranzicionit nga ish sistemi prokurorial në sistemin e ri prokurorial.
- Faza implementuese: Nga 1 Janari 2012 deri në 31 Dhjetor 2012 Këshilli duhet të nisë implementimin e planit.

Pas vendosjes së bazave të reformimit të sistemit publik prokurorial, hapat e ardhshëm konkret për reformim e gjyqësorit u prezentuan në Gusht të 2011. Sistemi gjyqësor bazuar në Ligjin për Gjykatat përfshinë: Gjykatat Themelore, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme. Gjykatat Themelore janë gjykata të shkallës së parë të Republikës së Kosovës. Gjykatat themelore kanë përgjegjësi të shqyrtojnë të gjitha rastet në shkallën e parë përveç nëse është paraparë ndryshe me ligj. Gjykata e apelit është e

vendosur në Prishtinë si gjykatë e shkallës së dytë që ka juridiksion në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Deri në pesëmbëdhjetë përqind (15%) të vendeve në Gjykatën e Apelit dhe në asnjë rast më pak se 10 vende, janë të garantuara për gjyqtarët e komuniteteve jo-shumicë në Kosovë. Gjykata Supreme është instanca më e lartë juridike në Kosovë që ka juridiksion në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Gjykata Supreme përfshinë Panelin për Ankesa të Agjensionit Kosovar për Privatizim dhe Dhomën Speciale të Gjykatës Supreme lidhur me çështjet e privatizimit. Sikurse në rastin e Gjykatës së Apelit, përbërja e Gjykatës Supreme duhet të reflektoj gjithë përbërjen etnike të popullatës së Kosovës me së paku pesëmbëdhjetë përqind (15%) të gjykatësve në Gjykatën Supreme por në asnjë rast më pak se (3) gjyqtarë të komuniteteve jo-shumicë në Kosovë.

Ligji i ri për gjykatat ka adresuar poashtu një ndër aspektet kyçe të motivimit të profesionistëve ligjor, siç janë pagat, si incentivë për të mbetur në gjyqësor. Gjatë punës së tyre, gjyqtarët do të marrin pagat si vijon:

- Kryetari i Gjykatës Supreme do të ketë pagën ekuivalente me Kryeministrin e Republikës së Kosovës;
- Të gjithë gjyqtarët e Gjykatës Supreme do të kenë pagën ekuivalente më atë të Ministrave në Qeveri;
- Gjyqtari kryesor në Gjykatën e Apelit do të ketë pagë ekuivalente me atë të gjyqtarit të Gjykatës Supreme;
- Të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Apelit do të kenë pagë ekuivalente në masën 90% të pagës së gjyqtarit kryesor të Gjykatës së Apelit;
- Gjyqtari kryesor i Gjykatës Themelore do të ketë pagë ekuivalente me atë të gjyqtarit të Gjykatës së Apelit;
- Gjyqtari mbikqyrës i degës në Gjykatën Themelore do të ketë pagë ekuivalente në masën 95% të gjyqtarit kryesor të Gjykatës Themelore;
- Secili gjyqtarë i Gjykatës Themelore do të ketë rrogë bazë të jo më pak se 70% të pagës së gjyqtarit kryesor të Gjykatës Themelore.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës është i autorizuar të miratoj skemën shtesë për kompenzim që bëhet në raste të përgjegjësiive unike të gjyqtarëve në rastet e veprave të rënda penale, çështjeve komerciale apo konflikteve administrative mirëpo shuma e përgjithshme e pagës bazë nuk duhet të kalojë masën 90% të pagës së gjyqtarit kryesor të Gjykatës Themelore.

Në mënyrë që të zbatohet struktura e re e gjykatës, ky orar i zbatimit është paraparë:

- Faza planifikuese: Nga 1 Janari 2011 deri 31 Dhjetor 2011 Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të përgatisë planin implementues për lehtësimin e tranzicionit nga ish sistemi gjyqësor në sistemin e ri gjyqësor.

- Faza implementuese: Nga 1 Janari 2012 deri në 31 Dhjetor 2012 Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të nisë implementimin e planit.

Zbatimi i skemës së pagave duhet të filloj së implementuari nga 1 Janari 2011.

## Nga Misioni i ESDP në EULEX

Bazuar në marrëveshjen gjithpërfshirëse, Kosova do të mbikqyret nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (PCN), i cili ka fuqi të gjera duke përfshirë edhe shfuqizimin e ligjeve dhe vendimeve të miratuara nga organet e Republikës së Kosovës si dhe largimin e secilit zyrtar në rast të shkeljes së marrëveshjes gjithpërfshirëse apo sundimit të ligjit në Kosovë. Gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtarë përzgjedhen nga misioni i Politikës Evropiane për Siguri dhe Mbrojtje (ESDP) me pëlqimin paraprak të PCN. Për më shumë, PCN ishte paraprë të ushtroj rolin edhe të Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian (PSBE) dhe në këtë kapacitet të drejtojë Misionin e ESDP në të cilin, shefi i saj emërohet nga Këshilli i Bashkimit Evropian. Misioni i ESDP do të ishte përgjegjës për mentorimin, këshillimin dhe monitorimin e autoriteteve të Kosovës në sferën e sundimit të ligjit dhe do të kishte funksione të caktuara ekzekutive në sferën e gjyqësisë, policisë, kontrollit të kufirit, doganave dhe shërbimit korrektues duke përfshirë hetimin e rasteve të krimeve të luftës, terrorizmit, krimet të organizuar, korrupsionit, krimeve ndëretnike, krimeve ekonomiko-financiare dhe krime të tjera të rënda.

Në pritje të bisedimeve për statusin që do të shpënin në drejtim të transferit të përgjegjësive nga UNMIK-u tek Bashkimi Evropian, ky i fundit megjithatë kishte themeluar Misionin Planifikues të njohur si EUPT në 2006. Objektivat e misionit kanë qenë (i) të inicohet planifikimi me qëllim të nisjes së një tranzicioni të lehtë për detyra të caktuara nga UNMIK-u dhe vendosja e mundshme e një misioni për menaxhimin e krizave të BE-së në sferën e sundimit të ligjit si dhe detyrat tjera që mund të identifikohen nga Këshilli i BE-së, (ii) ofrimi i këshillave teknike për BE-në për të kontribuar në mbështetjen e dialogut me UNMIK-un në vazhden e planeve të saj për redukimin dhe transferin e përgjegjësive tek vendorët. Zbarkimi i misionit planifikues (EUPT) ishte bërë brenda kornizës së Rezolutës 1244 dhe ligjërisht i bazuar në ftesën e PSSP-së në vitin 2006 dërguar përfaqësuesit të BE-së. Pas dështimeve të Këshillit të Sigurimit për ta miratuar marrëveshjen gjithpërfshirëse dhe duke marrë në konsideratë ndarjet e brendshme në BE lidhur me njohjen e shtetit të pavarur të Kosovës, ishte e pamundur që BE të pajtohej dhe misioni i ESDP të zbarkoj ashtu siç parashihej në marrëveshjen gjithpërfshirëse. Megjithatë, Këshilli Evropian i Ministrave të Jashtëm miratoi një plan të përbashkët për ta themeluar misionin evropian për sundimin e ligjit në Kosovës (EULEX) në Shkurt 2008, menjëherë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe në kohën kur Kosova ishte zyrtarisht dhe ekskluzivisht nën Rezolutën 1244.

Mandati i EULEX-it në planin e përbashkët ishte gati identik me pikat e marrëveshjes gjithpërfshirëse lidhur me misionin e ESDP. Detyrat e EULEX-it ishin të monitorojë, mentorojë dhe këshillojë institucionet e Kosovës në sferën e sundimit të ligjit dhe të hulumtojë kategori të caktuara të krimeve të rënda. Mirëpo, EULEX-i ka një mandat më të fortë krahasuar me pikat e marrëveshjes gjithpërfshirëse pasi që është poashtu përgjegjës për promovimin dhe vendosjen e sundimit të ligjit, rendin publik dhe sigurinë që përfshinë shfuqizimin e vendimeve operacionale të autoriteteve të Kosovës. EULEX-i ka poashtu mandat të përgjithshëm në mbështetje të institucioneve të Kosovës për vendosjen e sundimit të ligjit dhe sigurisë.

Në ditën kur u miratua plani i përbashkët për zbarkimin e EULEX-it, misioni nuk ishte mandatuar të operojë nën Rezolutën 1244. Planin e përbashkët nuk përmban referencë të ftesës së Kombeve të Bashkuara apo PSSP-së siç ishte rasti me planin paraprak për vendosjen e misionit planifikues EUPT. Edhe pse plani i përbashkët i referohet në preambulë Rezolutës 1244, BE nuk do të impononte në mënyrë të njëanshme zëvendësimin e UNMIK-it me EULEX-in apo zbarkimin e misionit të ri pa marrë pëlqimin paraprak të Këshillit të Sigurimit. Baza ligjore për zëvendësimin e UNMIK-it dhe vendosjen e EULEX-it do të mund të përmbylej vetëm në rast të dhënies së mandatit të ri nga Këshilli i Sigurimit ku në atë periudhë nuk e morri. Sekretari i Përgjithshëm i KB-së vetëm potencoi në raportin e tij dërguar

Këshillit të Sigurimit në Qershor të 2008 se ka pranuar një letër nga Përfaqësuesi Special i Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe Sigurisë i BE-së i cili e ka informuar për vullnetin e BE-së për të luajtur një rol të rëndësishëm në sferën e sundimit të ligjit në Kosovë bazuar në Rezolutën 1244. Në fakt, EULEX-i u injorua nga Sekretari i Përgjithshëm i KB-së që shkaktoi ngecjen e procesit për vendosjen e misionit evropian. Rezistenca e Rusisë dhe Serbisë ndaj EULEX-it dhe zëvendësimi i mundshëm i UNMIK-ut në fakt i bllokoi përpjekjet për arritjen e kompromisit në KB që do t'i lejonte UNMIK-un edhe EULEX-in të operojnë në terren paralelisht për një kohë. Mirëpo, "legalizimi" i EULEX-it nga KB ndodhi vetëm në Nëntor 2008 me kushtin që të operojë nën autoritetin e përgjithshëm të Rezolutës 1244 dhe kornizat KB-së për "neutralitetin ndaj statusit". EULEX-i u obligua të dërgoj raporte të rregullta te KB dhe vendosja e misionit do të kordinohej nga UNMIK-u. Rusia dhe Serbia pranuan këtë aranzhman për faktin se vendet anëtare të BE-së pranuan qasjen e EULEX-it për "neutralitet ndaj statusit" dhe pjesëmarrjen e prezencës së KB në Kosovë në zbatimin e "Planit të gjashtë-pikëshit". Ky plan bazohet në propozimin e bërë nga Sekretari i Përgjithshëm i KB-së drejtuar Presidentit të Serbisë në Qershor 2008 (e që u pranua nga ky i fundit në Nëntor 2008) ku parashihte mos-shtrirjen e kontrollës së autoriteteve policore, gjyqësore e doganore të Kosovës në rajonet e banuara me shumicë serbe por që parashihte vendosjen e tyre nën kontrollin direkt të KB-së në përputhje me Rezolutën 1244 dhe duke mos rrespektuar Kushtetutën e Republikës së Kosovës e marrëveshjen gjithpërfshirëse. Me "legalizimin" e EULEX-it nën këto kushte dhe në bazë të pëlqimit të Këshillit të Sigurimit në Nëntor 2008, EULEX u operacionalizua në Dhjetor 2008.

Perspektiva kosovare e sheh bazën ligjore për mandatin EULEX-it krejtësisht ndryshe. Në fakt, "Plani gjashtë-pikësh" u refuzua nga autoritetet e Kosovës dhe qartazi u potencua që institucionet vendore janë në favor të zbarimit të shpejtë të EULEX-it në Kosovë mirëpo bazuar në mandatin që parashihet në Deklaratën e Pavarësisë, marrëveshjen gjithpërfshirëse, Kushtetutën e Republikës së Kosovës, legjislacionin kosovar, planin e përbashkët të BE-së të Shkurtit 2008 dhe ftesën e institucioneve të Kosovës dërguar EULEX-it. Autoritet e Kosovës deklaruan se do të bashkëpunojnë me EULEX-in në procesin e vendosjes së misionit në tërë territorin e Kosovës, bazuar në dokumentet e lartëcekura dhe duke rrespektuar sovranitetin dhe tërësinë territoriale të Republikës së Kosovës. Të dy deklarimet e dorëzuara në KB, nuk përmendin as Rezolutën 1244 e as qëndrimin "neutralitet ndaj statusit" si pajtimin në mes KB-së dhe BE-së. Nga perspektiva kosovare, EULEX-i operon në mënyrë të ligjshme vetëm atëherë kur bazohet në dokumentet e listuara nga Kosova ngase ato përbëjnë bazën ligjore për mandatin e EULEX-it.

Megjithatë, plani i përbashkët për vendosjen e EULEX-it nuk i referohet marrëveshjes gjithpërfshirëse, Kushtetutës së Republikës së Kosovës, deklaratës së pavarësisë apo ftesës nga institucionet e Kosovës. Asnjë ndërlidhje nuk ekziston në mes ftesës së institucioneve vendore për vendosjen e EULEX-it dhe mandatit të kësaj të fundit të paraparë në planin e përbashkët ngase ftesës si të tillë nuk i është dhënë asnjë relevancë ligjore si bazë në të cilën EULEX-i do të vendosej apo operacionalizohej. Ky konstatim fuqizohet tutje me faktin se EULEX-i është vendosur nën konditat e "neutralitetit ndaj statusit" të Rezolutës 1244 që qartazi nuk është e paraparë në marrëveshjen gjithpërfshirëse, deklaratën e pavarësisë dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës, dokumente këto të cilat prerazi qartësojnë pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës.

Duke pranuar kushtet për të operuar nën Rezolutën 1244 dhe brenda kornizës ligjore të KB-së për "neutralitet ndaj statusit", EULEX-i në një mënyrë ka refuzuar apo injoruar dokumentet e listuara nga autoritetet e Kosovës që precizonin bazën ligjore për mandatin e EULEX-it. Misioni i EULEX-it i vendosur nën kondita të planit të përbashkët, Rezolutën 1244 dhe me qasjen "neutralitet ndaj statusit", ligjërisht nuk është identik me misionin e paraparë të ESDP të paraparë në marrëveshjen gjithpërfshirëse. Në këtë linjë, mund të ketë një dublifikim në aspekte të ndryshme të ushtrimit të mandatit sepse ligjërisht EULEX

nën kornizën e “neutralitetit ndaj statusit” është krejtësisht tjetër nga ajo që është paraparë për misionin e sundimit të ligjit në marrëveshjen gjithpërfshirëse ku përmendet në korniza të shtetit të pavarur e sovran edhe pse të mbikqyrur ndërkombëtarisht. Për më shumë, plani i përbashkët për vendosjen e EULEX-it i definon institucionet Kosovës si autoritete të krijuara në bazë të Rezolutës 1244. Në këtë mënyrë, kjo nuk përfshinë institucionet e Kosovës të themeluara në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe faktin që institucionet e kanë tani më legjitimitetin nga Kushtetuta e jo nga Rezoluta 1244 apo Korniza Kushtetuese.

Se zhvillimi i procesit të vendosjes së misionit për sundimin e ligjit nuk shkoi sipas pritjeve të BE-së u shpall në Qershor të vitit 2008 me të cilin u miratua dhe shpall Ligji për Juridiksionin, Zgjedhjen dhe Alokimin e Rasteve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë. Ligji si i tillë rregullon integrimin dhe juridiksionin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në kuadër të sistemit gjyqësor e prokurorial të Republikës së Kosovës. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, i është kërkuar Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut që t’ja dorëzojë Kryeprokurorit të EULEX-it dhe Kryetarit të Asemblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it (dhe bazuar në procedurat dhe modalitetet e pajtimit në mes UNMIK-ut dhe BE-së) të gjitha dosjet, informatat, arkivat dhe të dhënat elektronike apo të shtypura lidhur me rastet në hetim të prokurorëve ndërkombëtar të UNMIK-ut dhe Zyrës për Prokurori Speciale të Republikës së Kosovës, si dhe të gjitha rastet tjera që kanë qenë nën autoritetin e gjyqtarëve ndërkombëtar. Mirëpo, ky ligj ishte hartuar dhe shpallur në kohën kur EULEX-i pritej që të zbarkoj në Kosovë nën konditat e marrëveshjes gjithpërfshirëse i cili nuk u materializua ashtu siç ishte planifikuar. Ky ligj dhe në mënyrë eksplicite Ligji për Zyrën Speciale të Prokurorisë të Republikës së Kosovës (që janë hartuar në të njëjtën kohë), kanë paraparë “ditën tranzitore” – me fjalë tjera ditën kur misioni i EULEX-it ka filluar mandatin në Kosovë. Megjithatë, duke pasur parasysh që misioni i EULEX-it në ndërkohë është vendosur nën Rezolutën 1244 dhe kornizën për neutralitet ndaj statusit, është e paqartë nëse ligji ende shërbenë si bazë ligjore për “integrimin dhe juridiksionin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Republikës së Kosovës”. Gjyqtarët e EULEX-it nuk mund të integrohen në sistemin gjyqësor e prokurorial të Republikës së Kosovës me qasjen e “neutralitetit ndaj statusit” (që njëherit anashkalon shpalljen e pavarësisë së Kosovës dhe transformimin e saj në shtet) dhe duke operuar nën Rezolutën 1244.

Në këtë kontekst, konflikti kushtetues në mes Republikës së Kosovës dhe EULEX-it ishte i pashmangshëm i cili kulmoi në vitin 2011. Gjyqtarët e Dhomës Speciale për Çështjet e Agjensionit Kosovar të Mirëbesimit janë gjyqtarët të EULEX-it, që sipas raportit të Sekretarit të Përgjithshëm të KB-së janë nën autoritetin e PSSP-së dhe bazohen në legjislacionin e aplikueshëm në kuadër të Rezolutës 1244. Në këtë mënyrë, gjyqtarët nuk janë emëruar në pajtim me Kushtetutën dhe marrëveshjen gjithpërfshirëse. Në fakt, pas shpalljes së pavarësisë, Kuvendi i Kosovës ka miratuar ligjin e ri për themelimin e Agjensionit Kosovar të Privatizimit, që zëvendësoi ish-Agjensionin Kosovar të Mirëbesimit të themeluar nga UNMIK-u. Mirëpo në ndërkohë, Dhoma Speciale vazhonte të aplikonte legjislacionin e UNMIK-ut ngase ligji i ri rregullonte vetëm rregullimin e brendshëm. Sipas Dhomës Speciale, autoriteti legjitim ishte ende Agjensioni Kosovar i Mirëbesimit i cili përfaqësohej nga këshilltari ligjor i UNMIK-ut përderisa Agjensioni Kosovar i Privatizimit konsiderohej vetëm si entitet faktik. Në një vendim për patundshmëri në Mars të 2011, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës konfirmoi se Dhoma Speciale nuk i njuh dhe aplikon ligjet në fuqi të Kuvendit të Kosovës dhe se kjo e fundit vazhdoi së injoruari ekzistencën e Kosovës si shtet i pavarur dhe ligjet e saja të miratuara në Kuvend. Gjykata Kushtetuese konsideroi se në bazë të Ligji për Juridiksionin, Zgjedhjen dhe Alokimin e Rasteve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it është e papranushme që gjyqtarët e EULEX-it në kuadër të Dhomës Speciale të Gjykatës Supreme refuzojnë të aplikojnë ligjet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Me fjalë të tjera, është e paqartë se si gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it do të aplikojnë

Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës pa e shkelur vendosjen e EULEX-it nën ombrellën e “neutralitetit ndaj statusit” të Rezolutës 1244.

## **Roli i UNMIK-ut në Sistemin e Drejtësisë pas Pavarësisë**

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, Sekretari i Përgjithshëm i KB mbajti qëndrimin e Këshillit të Sigurimit që KB të vazhdojë të operojë nën Rezolutën 1244 përderisa kjo rezolutë është në fuqi dhe se UNMIK duhet të vazhdojë implementimin e mandatit të saj në përputhje me rrethanat e ardhshme. Megjithatë, miratimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës u përceptua si sfidë serioze për implementimin e mandatit të UNMIK-ut. Sekretari i Përgjithshëm hapur pranoi se ekziston konflikt ndërmjet Rezolutës 1244 dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës e cila nuk njeh rolin e UNMIK-ut. Përderisa PSSP-së ende i ipet rol ekzekutiv në bazë të Rezolutës 1244 ky nuk mund të ushtroj aktivitetin e tij. Me ndryshimin e rrethanave në terren, në Qershor të 2008, PSSP inicoi procesin e konfigurimit të UNMIK-ut. Si rezultat i zbarkimit të misionit të EULEX-it filloi edhe kalimi i përgjegjësive në sektorin e drejtësisë që u formalizua me nënshkrimin e marrëveshjeve për transferin e rasteve në hetime dhe dosjeve nga UNMIK-u te EULEX-i. Transferi përfundoi në Qershor të vitit 2009. Poashtu, Sekretari i Përgjithshëm i raportoi Këshillit të Sigurimit të KB se PSSP ka bërë hapa konkret për lejimin e emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it nën autoritetin e PSSP-së dhe në konsistencë me ligjin e aplikueshëm nën Rezolutën 1244.

Duke i transferuar kompetencat te EULEX-i, UNMIK-u rrjedhimisht reduktoi kapacitetet në sektorin e drejtësisë deri në nivel të Zyrës Ndërlidhëse për Sundimin e Ligjit. Nëpërmjet kësaj zyre, UNMIK-u mbeti ende aktiv në sferën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar dhe kërkesave respektive për shtetet të cilat nuk e kanë njohur Kosovën si dhe në çështjet që ndërlidhen më INTERPOL-in dhe Gjykatën Ndërkombëtare për Krime të Luftës për ish-Jugosllavi. Kjo gjendje ende vazhdon pavarësisht miratimit të një udhëzimi administrativ të Ministrisë së Drejtësisë në Shtator të 2009 ku bashkëpunimi juridik ndërkombëtar iu kalua si përgjegjësi Ministrisë së Drejtësisë.

## **Sistemi i Drejtësisë në Veri të Kosovës**

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, serbët e Kosovës të mbështetur nga Beogradi bojkotuan institucionet e reja të Republikës së Kosovës duke përfshirë këtu edhe sistemin e drejtësisë. Në Mars të 2008, në mënyrë të dhunshme rrethuan Gjykatën në pjesën veriore të Mitrovicës. Gjykata u rihap vetëm pas Tetorit 2008 me kusht që vetëm gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtar të punojnë në objekt dhe si të tillë të aplikojnë vetëm legjislacionin e UNMIK-ut nën Rezolutën 1244. Në Zubin Potok, gjykata komunale dhe për kundërvajtje nuk funksionojnë përderisa në Leposaviq gjykatat funksionojnë si pjesë e sistemit të drejtësisë të Serbisë. Kjo situatë nuk ka ndryshuar substancialisht që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës. Duke trashëguar EULEX-in në sferën e drejtësisë, EULEX-i vendosi vetëm një prani minimale në pjesën veriore të vendit (Mitrovica e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq) që mbulojnë vetëm rastet urgjente kriminale kurse autoritetet e drejtësisë së Kosovës nuk ushtrojnë juridiksion në atë pjesë. Indikacionet e fundit nga EULEX-i se rifunksionalizimi i sistemit të drejtësisë në pjesën veriore të vendit varet nga dialogu në mes Prishtinës dhe Beogradit u prit me rezistencë të madhe dhe kundërshtim të autoriteteve të Republikës së Kosovës.



## PËRFUNDIME

Vendosja e një sistemi efektiv të sundimit të ligjit mbetet ende një sfidë për Kosovën dhe si i tillë perceptohet kritik për zhvillimet e ardhshme në vend dhe integritet në Bashkimin Evropian. Brenda periudhës 10 vjeçare, Kosova është zhvilluar nga një gjendje e kollapsit total të sistemit të drejtësisë në zhvillimin relativisht të mirë të bazës institucionale në këtë sferë. Gjatë kësaj periudhe, ndërtimi i institucioneve ishte përcjellur me reforma të pjesshme institucionale dhe krijimin e organeve të reja. Ndarja e përgjegjësiave ndërmjet UNMIK-ut dhe Kosovës si dhe transferimi gradual i kompetencave nuk rezultoi në konsolidimin e institucioneve të drejtësisë në Kosovë ngase ato iu nënshtruan ndryshimeve konstante në aspektin organizativ. Me kornizën e re institucionale, sistemi i drejtësisë në Kosovë kërkon një stabilitet në mënyrë që të konsolidohet dhe të koncentrohet në përmirësimin e cilësisë, efikasitetit dhe performancës. Kjo nuk do të jetë detyrë e lehtë duke pasur parasysh që reforma e re në drejtësi është ende në fazën e planifikimit dhe duhet ende që të implementohet. Është pozitive që procesi i verifikimit është përmbyllur me sukses dhe se ka pasur përpjekje të zvogëlohet numri i rasteve të pazgjidhura në gjykata. Shfrytëzimi adekuat i resurseve dhe menaxhimi efikas është kyç për suksesin në reformën e sistemit të drejtësisë.

Megjithatë, sfidat ekzistojnë dhe si të tilla janë kryesisht politike. Vendosja e një sistemi juridik uniform në të gjithë territorin e Kosovës është sfidë e madhe. Ri-integrimi i pjesës veriore nën ombrellën e sistemit të drejtësisë të Republikës së Kosovës duhet të jetë një ndër prioritetet kryesore të autoriteteve kosovare. Për më shumë dhe në saje të vendimeve të fundit të Gjykatës Kushtetuese, autoritetet kosovare duhet të insistojnë tek prania ndërkombëtare që çdo ushtrim i juridiksionit gjyqësor apo prokurorial në territorin e Republikës së Kosovës duhet të bazohet dhe ushtrohet në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Është i domosdoshëm një dialog i sinqertë me Bashkimin Evropian dhe EULEX-in në këtë aspekt. Bazuar në vendimet e Gjykatës Kushtetuese, do të jetë vështirë për autoritetet kosovare të pranojnë EULEX-in të vazhdojë ushtrimin e autoritetit gjyqësor e prokurorial në Kosovë nën kornizën e neutralitetit ndaj statusit në kuadër të Rezolutës 1244. Në anën tjetër, BE do të ketë vështirësi në pranimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës pa e lënë anash qasjen për neutralitetin ndaj statusit. Me gjasë 'arranzhmanet politike' që ishin deri më tani në mes EULEX-it dhe Kosovës vështirë se do të mund të justifikohen në të ardhmen dhe se ka ardhur koha që BE ta rievlerësojë bazën ligjore për rolin e saj të rëndësishëm në Kosovë.

## LISTA E LEGJISLACIONIT

(Në rënditje kronologjike)

### UNMIK

1. Rezoluta e KS të OKB 1244 (1999)
2. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/1, e ndryshuar, mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë
3. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/5 mbi themelimin Gjykatës ad-hoc të Instancës së Fundit dhe të Zyrs ad-hoc të Prokurorit Publik
4. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/6 mbi Rekomandimet mbi Strukturën dhe Administrimin e Shërbimit të Gjyqësisë dhe të Prokurorisë
5. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/7, e ndryshuar, për emërimin dhe shkarkimin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve
6. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/18, e ndryshuar, për emërimin dhe shkarkimin e ndihmësgjyqtarëve
7. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/24, e ndryshuar, për Ligjin në Fuqi në Kosovë
8. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/1 mbi Strukturën e Përbashkët të Përkohshme Administrative
9. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/6, e ndryshuar, mbi emërimin dhe shkarkimin nga detyra të gjyqtarëve ndërkombëtarë dhe prokurorëve ndërkombëtarë
10. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/15 për themelimin e Departamentit Administrativ të Drejtësisë
11. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/30 mbi vulat dhe titujt e dokumenteve zyrtare të Gjykatave, Prokurorive dhe Instruconeve Penale
12. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/46 mbi Përdorimin e Gjuhes në shqyrtimet ku merr pjesë një gjyqtar ndërkombëtar ose prokuror ndërkombëtarë
13. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/64 mbi caktimin e gjyqtarëve-prokurorëve ndërkombëtarë dhe ndrërimin e vendit të tyre
14. Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut nr. 2000/13 zbatimi i Rregullores së UNMIK-ut nr 2000/6 mbi emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë
15. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/8 mbi themelimin e Këshillit Gjyqësor dhe të Prokurorisë të Kosovës
16. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9, e ndryshuar, mbi Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë
17. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/19, e ndryshuar, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë

18. Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut nr. 2001/4 (Njësia për Inspektim Gjyqësor)
19. Urdhëresa Administrative të UNMIK-ut nr. 2001/17 (Vlerësimi Ecuria e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve)
20. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2002/13 mbi themelimin e Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit
21. Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut nr. 2002/24 (Departamenti i Gjykatës Komunale në Ferizaj në Shtërpçë)
22. Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut nr. 2003/13 (Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit)
23. Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut nr. 2003/31 (Instituti Gjyqësor i Kosovës)
24. Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut nr. 2004/26 (Departamenti i Gjykatës Komunale të Prishtinës në Graçanicë)
25. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2005/52 mbi themelimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës
26. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2005/53, që përmirëson rregulloren e UNMIK-ut 2001/19 (krijimi i Ministrisë së Drejtësisë)
27. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/25 mbi kornizën rregulative të sistemit gjyqësor në Kosovë
28. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/26, që përmirëson rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/19 (Transferimi i përgjegjësisë shtesë për Ministrinë e Drejtësisë)
29. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/36 mbi Ndihmen Ligjore
30. Urdhëresa Administrative të UNMIK-ut 2006/8 (Procedurat disiplinore dhe të Apelit në Këshillin Gjyqësor të Kosovës)
31. Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut nr. 2006/15 (Zyra e Prokurorit Special të Kosovës)
32. Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut nr. 2006/18 (Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe i Prokurorisë)
33. Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut nr. 2008/7 (Zyra e Këshillit Disiplinor dhe Njësia e Auditimit Gjyqësor)

## **REPUBLIKA E KOSOVËS**

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës
2. Ligji mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë
3. Ligji për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës

4. Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës
5. Ligji për Përbërjen e Përkohshme e Këshillit Gjyqësor të Kosovës
6. Ligji mbi Gjykatat
7. Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës
8. Ligji për Prokurori të Shtetit
9. Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës

